

Kreu i OBVL-së, Rrahman Parllaku - "Nderi i Komunës" Kurvelesh

Titulli i lartë iu dorëzua gjeneral Parllakut nga kryetari i Komunës së Kurveleshit, z.Pëllumb Milori

FAQE 3



Prishtinë, shtatorja e presidentit historik Ibrahim Rugova në sheshin me emrin e tij

Juria ndërkombëtare dhe vendore nga njerëz të artit dhe kulturës ka përzgjedhur shtatoren nga 33 bocete konkurruese

FAQE 7



ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR (OBVL)

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 66 (297) TETOR 2013. ÇMIMI: 20 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA Adresa: Ministria e Mbrojtjes, Tiranë. Email: veterani.obvl@yahoo.com/ website: WWW.VETERANIOBVL.ORG

Një 70 vjetor për ata që mbetën gjithmonë të rinj

Nga Skënder MALINDI

Historia, në rrafshin akademik, është një shkencë e saktë, është një kronikë në kohë e ngjarjeve të një populli. Por ka dhe një aspekt njerëzor të saj, që nuk ka të bëjë me letrat e shkruara, Bëhet fjalë për "shkrimet" në ndërgjegjen dhe kujtesën e njerëzve, në respektin që tregojnë për të kaluarën, me të mirat dhe të këqijat...

FAQE 8

Testamenti i atdhedashurisë

Nga Halil RAMA

Shprehja e përbotshme "atdheu fillon te familja" është referencë e qindra kuvendeve, takimeve tryezave, sesioneve e konferencave shkencore. 100 vjet më parë qyteti i Dibrës dhe ai i Gjakovës ishin koncesionet e fundit që iu bënë monarkive të shteteve fqinje, që kishin pushtuar me forcën e armëve viset shqiptare gjatë luftërave ballkanike. Kjo padrejtësi historike u vendos në Konferencën e Londrës (1913), ku u caktuan kufijtë e shtetit...

FAQE 10

Rekuiem për ish gardistin shembullor Arben Zhuzhi

Nga Valsin TANELLARI

Një vit më parë, më 14 shtator 2012, ish punonjësi i Gardës së Republikës, Arben Zhuzhi humbi jetën në një aksident në krye të detyrës, si drejtues i mjetit të Sigurisë së Presidentit të Republikës. Të sh-tunën e këtij 14 shtatori atë e përkujtuam me nderim të veçantë familja dhe të afërmit si dhe ish kolegët e tij të shërbimit...

FAQE 9

Federata Panshqiptare "Vatra" në SHBA priti Kreun e Shtetit Bujar Nishani

"VATRA" FARKËTOI ALEANCËN ME SHBA, RUAJTI ATDHEDASHURINË



FAQE 6

Ambasador Donald Lu: SHBA ka nevojë për aleatë si Shqipëria

Shqipëria, një aleat i rëndësishëm i Shteteve të Bashkuara

FAQE 5

Meta në Pezë: Atdheu mbi të gjitha



FAQE 4

ME RASTIN E 70-VJETORIT TË KRIJIMIT TË BRIGADËS SË III-TË SULMUESE

Brigada e sukseseve të shumta

FAQE 2

KONFERENCA E LONDRËS PËRFAQËSON PJESËN MË TË DHIMBSHME TË SAJ PËR SHQIPTARËT

Viti 1913, si u sakrifikua Gjakova dhe Dibra për të shpëtuar Shkodrën

FAQE 11

DIMENSION I RI NË MARRËDHËNIET MIDIS MINISTRISË SË MBROJTJES DHE GARDËS KOMBËTARE TË NEW JERSEY

SHBA, 1.3 milion dollarë për programin e trajnimit të oficerëve shqiptarë

FAQE 12-13

HISTORIA

Me rastin e 70-vjetorit të krijimit të Brigadës së III-të Sulmuese

Brigada e sukseseve të shumta

• Vetë komandanti i batalionit gjerman, kapiteni Llokman, në kujtimet e tij thekson: "Luftimet e Arbanës kanë qenë më të ashprat që kam kaluar në Ballkan, që janë zhvilluar deri në përleshje balllore. U futëm në një kazan values nga i cili nuk dilnim dot, por falë perëndimit të diellit, errësira na shpëtoi nga asgjësimi", se "nuk po luftonim me partizanë, por me një ushtri të përgaditur mirë".

Populli ynë gjatë gjithë historisë së tij, ka përkujtuar dhe festuar me madhësi ngjarjet historike, që tregojnë heroizmin dhe vitalitetin e kombit tonë. I tillë është edhe përkujtimi dhe kremtimi i përvjetorit të 66-të të Brigadës së III-të Sulmuese.

E krijuar më 9 Tetor të vitit 1943, në fshatin Arbanë të zonës luftarake të Pezës, kjo njësi relativisht e madhe për kohën kishte në përbërje të saj partizanë të çetës së Pezës, të batalioneve "Dajti" e "Ishmi", intelektualë, të rinj, që erdhën nga qyteti i Tiranës, të gjithë me përvojë dhe të kalitur në betejat e ashpra luftarake me okupatorin, i cili synim kryesor kishte likuidimin e forcave partizane në krahinën e Pezës dhe në zonat rrethore të Tiranës.

Udhëheqja e brigadës bëri organizimin e shpejtë të forcave dhe mjeteve luftarake

Udhëheqja e brigadës bëri organizimin e shpejtë të forcave dhe mjeteve luftarake, caktoi detyrat e njësisë më të vogla, sqaroi situatën politike dhe luftarake, dhe menjëherë ra në ndeshje balllore me armikun në zonën e Pezës dhe në pikat më strategjike në periferi të Tiranës. Rruga luftarake e saj është e gjatë dhe aksionet e saj janë me të vërtetë herokike.

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare i ngarkoi detyrat të rëndësishme dhe shumë të vështira. Rrugën e saj, brigada e vazhdoi në zonën e Dajtit.

Forcat pushtuese, të alarmuara për aksionet dhe dëmtimet e mëdha që pësonin nga partizanët e Brigadës së III-të Sulmuese, organizuan dhe i bënë prita e rezistencë të madhe, sidomos gjatë kalimit për në Çermenikë e në të gjithë zonën e Elbasanit, ku i shkaktoi armikut humbje në njerëz dhe paisje lufte.

Në kushtet e një dimri shumë të egër, me kufizime shumë të mëdha në veshëmbathje, armatime e ushqime (që të gjitha këto i rrëmbeheshin armikut, por edhe nga populli ndihmohej e furnizohej) mundi t'i plotësojë me sukses detyrat shumë të vështira kundër një armiku shumë të madh në forca e mjete luftarake.

Një nga aksionet e suksesshme ka qenë mbajtja nën goditje dhe ndërprerja e herë pas herëshme e rrugës Elbasan-Tiranë, gjë që peng-

onte dhe bënte të dështonin veprimet e goditjet e armikut, që e kishte të domosdoshme lëvizjen në Jug e në veri të vendit. Vetë komandanti i batalionit gjerman, kapiteni Llokman, në kujtimet e tij thekson: "Luftimet e Arbanës kanë qenë më të ashprat që kam kaluar në Ballkan, që janë zhvilluar deri në përleshje balllore. U futëm në një kazan values nga i cili nuk dilnim dot, por falë perëndimit të diellit, errësira na shpëtoi nga asgjësimi", se "nuk po luftonim me partizanë, por me një ushtri të përgaditur mirë".

Më 17 tetor, njësi të Brigadës goditën me top nga kodrat e Saukut Asamblenë Kuislinge

Më 17 tetor, njësi të Brigadës goditën me top nga kodrat e Saukut Asamblenë Kuislinge dhe zhvilluan aksione të tjera edhe në qytetin e Tiranës. Marshimi luftarak vazhdoi në zonën e Skraparit dhe Përmetit. Gjatë luftimeve që u zhvilluan në Sukën e Përmetit, të drejtuara nga "Heroi i Popullit" Myslim Keta, iu shkaktua armikut një humbje e madhe dhe u bë e mundur të shpëtohet jeta e 17 fshatarëve, që ishin të zënë robër e që do të pushkatoheshin.

Brigada mori detyrë që në përbërje të Divizionit të I-rë Sulmues, me luftime të marshonte në drejtim të Verilindjes, Tiranë-Martanesh-Peshkopi-Kukës-Has dhe për në Malësinë e Gjakovës, nëpër një terren shumë ët thyer e malor, duke kaluar Drinin e Zi e Drinin e Bardhë, në një dimër të ashpër.

Në bashkëpunim me Brigadën e V-të Sulmuese, luftime të ashpra kemi zhvilluar në zonën e Peshkopisë e të Kukësit.

Me çlirimin e Tropojës në Tetor, luftime shumë të ashpra e të përgjakshme janë zhvilluar në zonën e Junikut në Kosovë, për çlirimin e Rrafshit të Dukagjinit, të qytetit të Gjakovës e të Pejës.

Detyrat luftarake i kemi vazhduar në drejtim të Malit të Zi e deri në Sanxhak të ish Jugosllavisë.

Heroizmi luftarak, trimëria deri në përleshje me armikun, dashuria deri në vdekje mes partizanëve ishin cilësitë e vjera të efektivit.

Në luftime dhanë jetën shumë partizanë e patrizane të kësaj brigade si "Heroina e Popullit" Ylberë Bylikbashi, komisar i Birçe Sinomati, dëshmorët Kapo Ademi, Kozma Papa, Sali Ymeri, Ali Derishi e shumë të tjerë.



Në Dhjetor të vitit 1945, brigada kthehet në Atdhe duke plotësuar detyrat për çlirimin e Atdheut, gjithashtu edhe në ndihmë të popujve të ish-Jugosllavisë, udhëheqja e së cilës asnjëherë nuk i vlerësoi veprimet luftarake të brigadave e divizioneve tona partizane, pa ndihmën e të cilave do të vështirëso-

hej çlirimi i jugosllavisë. Përkundrazi, udhëheqja e Beogradit, për gjysmë shekulli, shfrytëzoi dhe keqtrajtoi barabarisht popullin shqiptar të Kosovës, duke kaluar deri në genocid dhe asgjësimin fizik të tij.

Falë rezistencës kosovare, ndihmës politike, diplomatike e deri

me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s dhe mbështetjes së madhe të shetit e të popullit Shqiptar, Kosova arriti pavarësinë e shumëkërkuar.

Nga Shaban REÇI
Ish kuadër i Brigadës së II-të S dhe ish kryetar i Degës OBVL Tiranë (shkruar në tetor 2002)

Homazh për ish mësuesin shembullor Ferit Voci

Profesor Feriti ka edukuar breza të rinjsh të cilët e kujtojnë me nderim e respekt të veçantë

Më 17 shtator u nda nga jeta profesor Ferit Voci. Ai ka lindur më 20 prill 1928 në qytetin e Elbasanit. Biri i një familje patriotike dhe intelektuale, shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje. Më vonë kreu studimet e larta në Universitetin e Tiranës.

Gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Feriti, si dhe shumica e të rinjve mori pjesë në Grupin e Djemve (debatikas) të Elbasanit. Ai dha kontributin e tij deri në çlirimin e plotët të atdheut nga okupatori nazifashist.

Mbas çlirimit punoi si arsimtar në shkolla të ndryshme të vendit.

Më 1954 vjen e vendoset në qytetin e Durrësit ku punoi si drejtor shkollë deri sa doli në pension. Ai dha një kontribut të veçantë në zhvillimin e konsolidimit të sistemit tonë arësimor. Veçanërisht shquhej për stilin e mësimdhënies dhe për futjen e metodave bashkëkohore në shkollën shqipe.

Ishte komunikues, i dashur me gjithë kolegët arsimtarë dhe me nxënësit e prindërit e tyre.

Ferit Voci ishte dhe një bash-



këshort e prind shembullor, karakteristikë kjo që evidentohet nga gruaja dhe dy fëmijët e tij të mrekullueshëm.

Kontributi i tij është vlerësuar me shumë tituj nderi. Përveç dekoratës me rastin e 60-vjetorit të çlirimit të Atdheut, Këshilli Bashkiak i Durrësit i ka dhënë titullin "Mirënjohja e qytetit", ndërsa Këshilli i Përgjithshëm i OBVL

e ka shpallur "Veteran Nderi".

Profesor Feriti ka edukuar breza të rinjsh të cilët e kujtojnë me nderim e respekt të veçantë.

Në vitin 1993, ai me disa shokë të tjerë si Idriz Hoxha, Zenel Bardhi, Ernest Jakova, Genc Ballanca, Llukan Todhe etj formuan degën e OBVL të rrethit Durrës, ku profesor Feriti që në fillim u zgjodh anëtar i kryesisë së kësaj dege (funksion që e kreu me dinjitet deri sa vdiq).

Ne shokët e tij përulemi para profesor Feritit me dhimbje të thellë. Me vdekjen e tij humbëm shokun e bashkëpunëtorin tonë të vyer, ndërsa familja dhe të afërmit humbën njeriune tyre më të dashur. Me këtë rast atyre ju solli një mesazh ngushëllimi kryetari i OBVL-së, Rrahman Parllaku.

Ferit Voci u përcoll për në banesën e fundit me të gjitha nderimet që meritonte si mësues dhe intelektual shembullor.

GENC BALLANCA
Kryetar i OBVL, Dega Durrës.

NDERIMI

Titulli i lartë iu dorëzua gjeneral Parllakut nga kryetari i Komunës së Kurveleshit, z.Pëllumb Milori

Kreu i OBVL-së, Rrahman Parllaku - "Nderi i Komunës" Kurvelesh

Këshilli i Komunës Kurvelesh, Tepelenë, në mbledhjen e datës 17 Gusht 2013 vendosi të shpallë Z.Rrahman Latif Parllaku "Nderi i Komunës" me motivacionin: "Njeri me vlera të larta intelektuale, të cilat i ka demonstruar dhe vazhdon ti demonstrojë edhe sot.

Burrë që u ka barë ballë me fisnikëri gjithë vështirësive të jetës, mik i vjetër i krahinës së Kurveleshit".

Ky titull i lartë iu dorëzua gjeneral Parllakut nga kryetari i Komunës së Kurveleshit, z.Pëllumb Milori në një ceremoni të thjeshtë, por mbresëlënëse, ku merrnin pjesë drejtues të OBVL-së, kryetari i Këshillit të Komunës së Kurveleshit, z. Gëzim Pana, historiani i mirënjohur Pëllumb Xhufi, ish deputeti Auron Tare, pjestarë të familjes dhe të afërm të gjeneralit në pension.

Ndërsa ka publikuar këtë titull për Heroin e Popullit Rrahman Parllaku dhe motivacionin përkatës, kryetari i komunës së Kurveleshit z.Pëllumb Milori ka vlerësuar kreun

alëve të këtij rangu, ai solli në vëmendjen e pjesëmarrësve në këtë ceremoni festive rolin determinant të gjeneral Parllakut në organizimin dhe drejtimin e njësiteve partizane, nga ato guerile deri tek brigada e divizione, drejtimin me kompetencë e profesionalizëm të strukturave më të larta të Ushtrisë shqiptare, si dhe stoicizmin me të cilin ai përballoi akuzat e pabaza dhe vitet e burgut të vuajtur padrejhtësisht dhe për të cilat ka marrë pafajësinë nga Gjykata e Kasacionit.

Këto cilësi të larta të z.Parllaku u evidentuan edhe nga nënkryetarët e OBVL-së, Skënder Malindi e Myfit Guxholli, si dhe krzetari i OUPD Dhimiter Ndrenika . Ata falenderuan kretët e komunës së Kurveleshit për titullin që i dhanë kreut të OBVL-së, duke e konsideruar atë si nder që i bëhet Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Nga ana e tij, z.Parllaku shpreh mirënjohjen për nderimin me këtë titull nga këshilli i Komunës Kurvelesh. Ai falenderoi autoritetet



kryetari i komunës, Z.Milori dhe nga Z.Isa Tare, kreu i OBVL-së bëri një vizitë në komunën e Kurveleshit. Bashkë me ta, Z.Parllaku vizitoi familjen e vëllait të Heroit të Popullit Hito Çako (Gjik Çako), familje kjo ku ai është pritur e strehuar në vitet e zjarra të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Mjaftë mbresëlënëse ishte dreka e shtruar nga kryetari i Komunës së Kurveleshit për Heroin e Popullit Rrahman Parllaku, gjeneral - lejtentant në pension. Në këtë drekë ku merrnin pjesë dhe vetaranë të LANÇ e të ftuar të tjerë, me kërkesën e tyre, Z.Parllaku, solli në vëmendje kujtimet e disa betejave luftarake të zhvilluara

në këtë krahinë kundër okupatorëve nazifashistë, në të cilat ai ka qenë pjesëmarrës.

Pjesëmarrësit ndoqën me vëmendje kujtimet e z.Parllaku për thyerjen e operacionit nazist të Dimrit 1943-1944, në atë terren malor dhe në kushtet e një dimri tejet të ashpër, ku partizanët bënë sakrificë mbinjerëzore. Kryetari i OBVL falenderoi kryekomunarin e Kurveleshit, Z.Milori për ftesën dhe mikpritjen e veçantë, vëllazërore e të ngrohtë.

I mallëngjyer nga vizita në ato vende ku i vinin në kujtesë shokët e shoqet e rinisë, Parllaku nderoi me respekt të veçantë kujtimin e 23 ish luftëtarëve të lirisë që mbetën të vrarë e të ngrirë në borë në luftimet e 2-6 shkurtit në Salari e Malin e Këndrevicës së Dhemblanit. Po ashtu ai solli në kujtesë edhe shumë të tjerë të plagosur të cilët mbetën invalid për jetë.



e OBVL-së si krenaria e krahinës së tij.

"Gjeneral Parllaku mban titullin e lartë "Hero i Popullit" dhe si i tillë edhe i Kurveleshit. Ky titull nderon në radhë të parë komunën tonë, për të cilën ai ka dhënë një kontribut të vyer si në kohën e Luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare, gjatë viteve kur drejtoi me nder e dinjitet ushtrinë shqiptare dhe këto vite si kryetar i OBVL-së", - u shpreh ndër të tjera kryetari i Komunës së Kurveleshit, z.Pëllumb Milori.

Prof.Dr.Pëllumb Xhufi, në fjalën e tij përshëndetëse u ndal veçanërisht tek potenciali intelektual e njerëzor që mbart figura e Heroit të Popullit Rrahman Parllaku. Pasi dënoi genocidin e pashembullt të dikaturës komuniste ndaj gjener-

e kësaj komune për vlerësimin e veçantë që i bënë vetëm pak kohë pas vizitës që ai zhvilloi në këtë komunë.

Ceremonia u shoqërua dhe me një koktejl si dhe me një drekë festive që shtroi familja Parllaku.

Pak mkohë më parë, Komuna e Kurveleshit dhe Organizata e Familjeve të Dëshmorëve të LANÇ organizuan një ceremoni përkujtimore, në 70-vjetorin e rënies së Heroit të Popullit, Asim Zeneli. Pranë memorialit të tij në Grykën e Këlcyrës vendosi një kurorë me lule dhe përshëndeti të pranishmit edhe kryetari i OBVL-së Rrahman Parllaku, i cili mori pjesë në këtë veprimtari përkujtimore, me ftesë të autoriteteve lokale të komunës së Kurveleshit.

Pas ceremonisë, i shoqëruar nga

Z.Parllaku foli për sakrificat sublimë që bënë luftëtarët e lirisë në moshën e rinisë dhe të adoleshencës 13-15 vjeçare.

Kryetari i OBVL u bëri thirrje autoriteteve vendore, të rinjve dhe të rejave që të kujdesen për mirëm-

bajtjen e memorialëve e të varrezave të dëshmorëve, si pjesë e historisë sonë kombëtare..

Bashkë me mallëngjimin, z.Parllaku pati kënaqësinë të shohë vendin që po rilind nga puna e popullit tonë vital.

AKTUALITET

Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli inspekton Forcën Tokësore

Rritja e dinjitetit të individit në Forcat tona të Armatosura

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, e shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi, ka zhvilluar më 24 shtator 2013 një inspektim në Komandën e Forcës Tokësore në Zall-Herr.



Fillimisht, ministrja e Mbrojtjes Kodheli u prit me Truproje Nderi nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku. Më pas ajo zhvilloi një takim me gjeneralmajor Dushkun në zyrën e tij, ndërsa më tej, në sallën e mbledhjeve të Komandës së Forcës Tokësore, ministrja Kodheli bëri një takim me shefat kryesorë të shtabit të kësaj komande.

Nga shefi i shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Adi Ndoni, u paraqit një briefing për misionin, detyrat, strukturat, arritjet dhe problematikën e Forcës Tokësore. Në vijim ministrja Kodheli është njohur me raportimet e shefave kryesorë të shtabit të Forcës Tokësore, të cilët paraqitën arritjet e shënuara në realizimin e programeve dhe të detyrave ushtarake, prioritetet, synimet dhe problematikën që kanë hasur gjatë procesit të realizimit të misionit të tyre.

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli ka vlerësuar informimin që iu bë nga drejtuesit kryesorë të komandës dhe shtabit të Forcës Tokësore, duke nënvizuar nevojën e krijimit të një raporti më të mirë mirëbesimi midis njëri-tjetrit, si një ndër faktorët kryesorë që ndikon në mbarëvajtjen e punëve. Më tej, ministrja Kodheli ka nënvizuar rritjen e dinjitetit të individit në Forcat tona të Armatosura, si një ndër prioritetet e qeverisë së re. Kjo do të realizohet që nga respekti që duhet të kemi për njëri-tjetrin, nga respekti që duhet të tregojmë për parandë publike që duhet ta shpen-

zojmë për të mirën e përbashkët dhe deri te detyrimet që kemi si vend anëtar i NATO, ka theksuar znj. Kodheli.

Në fund të këtij takimi, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, i ka dorëzuar ministres Kodheli stemën e Forcës Tokësore.

Më pas, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, e shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, ka vizituar Qendrën e Gjuhëve të Hua-ja dhe mjedise të tjera të kësaj komande.

Zhvillohet ceremonia e marrjes së detyrës nga ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli

Pas marrjes së votëbesimit të qeverisë së re nga Kuvendi i Shqipërisë, më 16 shtator në Ministrinë e Mbrojtjes u organizua një ceremoni e veçantë me rastin e marrjes së detyrës nga ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli.

Në këtë ceremoni mori pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi, komandantët e Forcave, gjeneralë, drejtorë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA. Gjithashtu ishin të pranishëm atashetë ushtarakë të vendeve të NATO dhe atyre partnere të akredituar në vendin tonë, përfaqësues të Zyrës së ODC dhe CUBIC. Në këtë ceremoni ministrja e Mbrojtjes Kodheli është shoqëruar edhe nga disa deputetë të Kuvendit të Shqipërisë.

Fillimisht, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, u prit me Truproje Nderi dhe Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi. Në vijim, ministrja Kodheli ka takuar nga afër komandantët e Forcave, gjeneralë, drejtorë, ushtarakë të tjerë të lartë, atashetë ushtarakë etj., që ishin të pranishëm në këtë ceremoni.

Më pas, shoqëruar nga gjeneralmajor Gjunksi, ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli ka nisur detyrën e re në zyrën e saj të punës. Më herët, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, mori pjesë në ceremoninë që u zhvillua në Pezë me rastin e 71-vjetorit të Konferencës së Pezës, ku në emër të qeverisë ka përshëndetur të pranishmit.



Ministrja Kodheli viziton familjen e "Dëshmorit të Atdheut" kapiten Feti Vogli

Mesditën e datës 20 shtator 2013, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, bëri një vizitë në familjen e "Dëshmorit të Atdheut" kapiten Feti Vogli në fshatin Baldushk të Tiranës, i cili më datë 20 shkurt 2012 ra në krye të detyrës gjatë kryrjes së misionit paqeruajtës në Kandahar të Afganistanit.

Kjo vizitë është ndër aktivitetet e para që znj. Kodheli ka realizuar pas marrjes së detyrës të ministres së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë. Gjatë kësaj vizite ministrja Kodheli shoqërohej nga deputeti i

Kuvendit të Shqipërisë, z. Xhemal Qefalia dhe komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli u prit nga nëna, vëllai dhe motra e "Dëshmorit të Atdheut" kapiten Feti Vogli, si dhe nga të afërmet të tjerë të kësaj familje. Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, duke iu drejtuar familjarëve të kapiten Feti Voglit, theksoi se, kam ardhur këtu për të shprehur edhe njëherë jo vetëm ngushëllimet e mia personale, të cilat i kam shprehur edhe kur djali juaj i dashur ra në krye të detyrës, por edhe

për të shprehur mbështetjen që do të keni në të ardhmen, si një detyrim i shtetit, por veçanërisht i Ministrisë së Mbrojtjes që unë drejtoj, në respekt dhe në kujtim të veprës së tij heroike. Nga ana e familjes, vëllai i dëshmorit, Florenc Vogli, falenderoi ministrin Kodheli për vizitën që bëri në familjen e tyre brenda një kohe të shkurtër nga marrja e detyrës si ministre e Mbrojtjes, për vlerësimin që ajo i bëri figurës dhe aktit heroik të Feti Voglit, si dhe për mbështetjen që ajo shprehu në emër të Ministrisë së Mbrojtjes për familjen e tij.

Meta në Pezë: Atdheu mbi të gjitha

Në 71-vjetorin e Konferencës së Pezës, kreu i Kuvendit, Ilir Meta në një deklaratë për mediat u shpreh se kjo konferencë duhet të na shërbejë të gjithëve për të qenë të bashkuar".

"Duhet të marrim mesazhe të qarta nga Konferenca e Pezës. Bashkimi dhe bashkëpunimi është në interes të zhvillimit të kombit", u shpreh Meta. "Pezë do të thotë bashkim. Pezë do të thotë atdheu mbi të gjitha". Kështu ka deklaruar kreu i Kuvendit, Ilir Meta, pas homazheve ne nderim te festimeve per 71 -vjetorin e Konferencës së Pezës.

Sipas Metes, kushtrimi që vjen sot pas kaq dekadash, nga Konferenca e Pezës e 16- shtatorit të vitit 1942 duhet të ligjërohet nga të gjithë, duhet t'ia transmetojmë edhe brezave që vijnë.

"Pra, bashkim dhe bashkëpunim

edhe brezave që vijnë pa dallim feje, krahine dhe ideje në interes të atdheut, në interes të kombit"- tha ai.

I pyetur per vendimin per heqjen e fotos se Nishanit dhe zevendesimin me ate te Ismail Qemalit, Meta ka thene:

"Kjo nuk ka asnjë lidhje me këtë çështje. Fakti që do të jetë një figurë themeluese e shtetit shqiptar, siç është figura e Ismail Qemalit i cili është një mesazh bashkimi. Mendoj se të gjithë duhet ti mbajmë të gjalla ideat e Konferencës së Pezës, patriotëve shqiptar, komunistëve, nacionalistëve të asaj kohe të cilët kapërcyen diferencat e tyre në emër të interesit të madh, të lirisë së atdheut dhe progresit shoqëror".

Edhe ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, mori pjesë në ceremoninë që u zhvillua në Pezë me ras-

tin e 71-vjetorit të Konferencës së Pezës, ku në emër të qeverisë ka përshëndetur të pranishmit.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin veteranë, deputetë, si dhe personalitete të ndryshme të vendit.

Më 16 shtator 1942 u mbajt në fshatin e Pezës, disa kilometra larg Tiranës, Konferenca e Pezës, e njohur në historinë e popullit shqiptar si kuvendi i parë pluralist. Protagonistë të këtij kuvendi ishin përfaqësues të krahinave dhe besimeve të ndryshme fetare, klasa dhe shtresa me bindje politike nga më të ndryshmet. Në konferencë u diskutua organizimi i forcave në një luftë të përbashkët kundër okupatorit, organizim ky që mori emrin më vonë, Fronti Nacional-Çlirimtar.

Konferenca e Pezës njihet si përjeksja e parë madhore për unifikimin



e faktorit shqiptar, duke e renditur vendin përkrah koalicionit botëror antifashist. Platforma kryesore e konferencës ishte bashkimi i shqiptarëve pa dallim feje, krahine dhe ideje në frontin nacionalçlirimtar. Në sheshin

para shtëpisë muze ku 71 vjet më parë zhvilloi punimet Konferenca e Pezës kishin ardhur qindra veteranë të Luftës Antifashiste, banorë të zonës së Pezës si dhe personalitete të politikës shqiptare.

TAKIMI

Dimension i ri në marrëdhëniet midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe Gardës Kombëtare të New Jersey

SHBA, 1.3 milion dollarë për programin e trajnimit të oficerëve shqiptarë

• *Departamentet e Shtetit dhe të Mbrojtjes, si dhe ushtria kanë dhënë autorizimin ligjor që është i nevojshëm në mënyrë që ushtria amerikane të trajnojë oficerët shqiptarë. Ato po angazhojnë një grant prej 1.3 milion dollarë për këtë program*

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, pritimë 18 shtator 2013 në një takim të veçantë ambasadorin e SHBA-së në Tiranë, z. Alexandër Arvizu. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe sekretari i përgjithshëm i MM, z. Arian Kraja, drejtori i Kabinetit, z. Gjergj Teneqexhiu, këshilltari i kryeministrit për Mbrojtjen, gjeneral brigade (R) Sandër Lleshi, këshilltari ushtarak i ministrit të Mbrojtjes, gjeneralmajor Arian Zaimi, si dhe disa drejtorë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm. Ndërsa nga pala amerikane ishte i pranishëm edhe zëvendësambasadori amerikan, z. Henry Jardine, atasheu ushtarak, Glenn Broën, oficer shtabi për Operacionet e Përbashkëta në Gardën e Neë Jersey, kolonel Kevin Hegarty, komandanti i Institutit Rajonal të Trajnimeve Ushtarake në Neë Jersey, kolonel Dean Spenzos, shefi i zyrës së ODC, major Christopher Mitchell, si dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ambasade.

Në këtë takim, ambasadori Arvizu ka uruar znj. Mimi Kodheli për detyrën e re si ministre e Mbrojtjes, ndërsa ministrja Kodheli vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera midis Republikës së Shqipërisë dhe SHBA, si aleati kryesor strategjik i vendit tonë, ndihmën dhe mbështetjen e fuqishme që SHBA dhe Forcat e saj të Armatosura kanë dhënë dhe vijojnë të japin për Forcat e Armatosura Shqiptare. Më pas është diskutuar për rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes midis dy vendeve dhe ushtrive tona.

Pas takimit, ministrja e Mbrojtjes,

znj. Mimi Kodheli dhe ambasadori amerikan Arvizu dhanë nga një deklaratë për mediat. Ministrja Kodheli theksoi se, në ditën time të tretë të punës, kam kënaqësinë të firmos një dokument, i cili jo vetëm shënon fillimin e një programi të rëndësishëm me Gardën Kombëtare të New Jersey, por është gjithashtu tregues i një dimensionit të ri në marrëdhëniet midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe Gardës Kombëtare të Neë Jersey. Përfitoj nga rasti, të shpreh mirënjohjen time për mbështetjen që Garda ka dhënë për FA të Shqipërisë, përmes programit të saj të Partneritetit. Duke u ndalur në çështjen e përgatitjes së oficerëve të rinj, ministrja Kodheli theksoi: "Ne ndajmë të njëjtin mendim se edukimi është shumë i rëndësishëm në përgatitjen e personelit ushtarak për sfidat e së ardhmes. Ata janë një aset me shumë vlerë i Forcave tona të Armatosura. Në këtë kontekst, si ministre e Mbrojtjes, jam shumë e angazhuar për të bërë të mundur që ne të përzgjedhim kandidatët më të mirë dhe më të motivuar për këtë program, por jo vetëm. Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm do të bëjnë më të mirën për të përfituar nga ndihma e dhënë nga Shtetet e Bashkuara. Jam e sigurt se ky program do t'ju vijë në ndihmë FA për të rritur më tej nivelin e interoperabilitetit dhe standardizimit, jo vetëm me Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara, por edhe me forcat e armatosura të vendeve të tjera të NATO", - ka nënvizuar ministrja e Mbrojtjes Kodheli.



Znj. Kodheli ka falënderuar në mënyrë të veçantë stafin e Zyrës së Bashkëpunimit Ushtarak Amerikan pranë Ministrisë së Mbrojtjes për përpjekjet e bëra në bashkëpunim me stafin shqiptar, në zhvillimin e konceptit të këtij programi. Në fund të fjalës së saj ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, në emër të qeverisë së Shqipërisë, ka falënderuar edhe një herë ambasadorin Arvizu për këtë mbështetje me shumë vlerë dhe ka siguruar për angazhimin maksimal në forcimin e partneritetit ekzistues strategjik mes Shteteve të Bashkuara dhe Forcave tona të Armatosura të Shqipërisë.

Në deklaratën e tij, ambasadori i SHBA, z. Alexandër Arvizu, u shpreh se, thajse një vit më parë Ministria e Mbrojtjes dhe FA zhvilluan konsultimet dypalëshe amerikano-shqiptare të mbrojtjes. Drejtues të lartë të FA, këshilltari ushtarak i kryeministrit, gjeneral brigade në lirim, Sandër Lleshi dhe këshilltari politik i presidentit, gjeneral brigade Jeronim Baze, propozuan një

ide novatore për të pëmbushur këto tre gjëra. Së pari rritjen e profesionalizmit të Forcave të Armatosura; së dyti përmirësimin e numrit të rekrutimeve dhe ruajtjen e tyre dhe së treti, ndihma për Shqipërinë për ta bërë trupën e oficerëve dhe nënoficerëve të ndërprerueshme me SHBA dhe NATO. Në bashkëpunim me shtetin e Neë Jersey përfaqësuar sot këtu nga oficeri i Operacioneve të Përbashkëta të Gardës Kombëtare dhe komandanti i Institutit të Bashkëpunimit Rajonal i morëm synimet e gjeneralëve dhe i bëmë realitet. "Sot, - ka nënvizuar ambasadori Arvizu, - po njoftojmë se Departamentet e Shtetit dhe të Mbrojtjes, si dhe ushtria kanë dhënë autorizimin ligjor që është i nevojshëm në mënyrë që ushtria amerikane të trajnojë oficerët shqiptarë dhe se po angazhojmë një grant prej 1.3 milion dollarë për këtë program". Ky autorizim, ka vijuar më tej ambasadori Arvizu, paraqitet sot këtu nga Letra e Ofertës dhe Pranimit të saj. Firma e ministres Kodheli në këto letra do të lejojë

Gardën Kombëtare të Neë Jersey dhe FA Shqiptare të programojnë me siguri burimet dhe të përpunojnë e miratojnë planet për ekzekutimin e programit pilot me një numër nga 15 deri në 50 kandidatë brenda harkut kohor maj-korrik 2014. Dëshiroj të theksoj se kjo klasë me këtë program do të jetë i pari i këtij lloji në historinë e programit të partneritetit të shtetit dhe të rrjetit tonë kombëtar të shkollave për oficerë ushtarakë. Kjo është një mundësi unike dhe bëhet për herë të parë. Është me vend që një nder i tillë i shkëlqyer të bëhet për miq dhe aleatë kaq të ngushtë të SHBA siç është Shqipëria", ka përfunduar ambasadori Arvizu.

Në fund, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, ka nënshkruar "Letter of Offer and Acceptance", (Letra e ofertës dhe pranimit) ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Gardës Kombëtare të New Jersey.

Valsin TANELLARI

Ambasador Donald Lu: SHBA ka nevojë për aleatë si Shqipëria Shqipëria, një aleat i rëndësishëm i Shteteve të Bashkuara

Donald Lu, i emëruari i Presidentit Barak Obama në postin e ambasadorit të Shteteve të Bashkuara në Shqipëri tha gjatë seancës së dëshme në Nënkomisionin e Senatit për Çështjet Evropiane se Shqipëria është një aleat i rëndësishëm i Shteteve të Bashkuara. "Në një botë me rreze të vazhdueshme dhe pasiguri, Shtetet e Bashkuara kanë më shumë nevojë për aleatë të shkëlqyer si Shqipëria".

Zoti Lu tha se përparësitë e tij do të jenë ndihma për forcimin e institucioneve demokratike të Shqipërisë, mbështetja e forcave të armatosura

shqiptare që të ngrihen në nivelin e aleatëve të NATO-s dhe nxitja e investimeve amerikane. Zoti Lu vlerësoi edhe zgjedhjet e fundit parlamentare në Shqipëri. "Zgjedhjet ishin më të mirat që ka zhvilluar Shqipëria ndonjëherë, pati një kalim paqësor pushteti, por demokracia nuk është vetëm zgjedhje. Ne do të nxisim udhëheqësit e të dyja palëve të luftojnë krimin e organizuar, trafiket dhe korrupsionin. Shtetet e Bashkuara duhet të vazhdojnë të mbështesin zërin në rritje të shoqërisë civile, mbrojtjen e të drejtave të pakicave, pavarësinë e gjyqësorit dhe

përgjegjshmërinë e politikanëve".

Shtetet e Bashkuara tha diplomati amerikan i mbështesin plotësisht synimet e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. "Ekonomia e Shqipërisë ka patur rritje të madhe gjatë viteve, por ashtu si edhe ekonomitë e shumë vendeve të tjera aleate, ajo ka mbetur në vend gjatë dy viteve të fundit. Dy janë mundësitë më të mëdha për rimëkëmbjen e saj: së pari, aftësia e Shqipërisë për të ndërmarrë reforma të rëndësishme ekonomike, për të krijuar një atmosferë më të shëndetshme për bizneset, dhe së dyti, forci-



mi i partneriteteve ekonomike të Shqipërisë me Europën dhe Shtetet e Bashkuara". Për një vend të vogël prej vetëm 3 milionësh, tha ai, Shqipëria pa dyshim jep një kontribut të madh për madhësinë e saj dhe Shtetet e Bashkuara duhet ta mbështesin atë të modernizojnë forcat e saj të armatosura që të plotësojnë standardet e një vendi aleat të NATO-s. "Në të njëjtën kohë ne duhet të ndi-

hmojmë Shqipërinë të luftojë korrupsionin dhe përgjegjshmërinë brenda ushtrisë që ajo të plotësojë standardet më të larta të një aleati të NATO-s". Donald Lu është diplomat karriere dhe për më shumë se dy dekada ai ka shërbyer në Departamentin e Shtetit, duke punuar në demokracitë e reja të dala nga ish vendet e Bashkimit Sovjetik dhe të Evropës Lindore.

DIASPORA

Federata Panshqiptare "Vatra" në SHBA priti Kreun e Shtetit Bujar Nishani

"Vatra" farkëtoi aleancën me SHBA, ruajti atdhedashurinë

Gjatë vizitës së tij në SHBA, Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, më 25 shtator 2013 u takua dhe u përshëndet për zemërsisht me shqiptarët e "Vatres" duke vlerësuar se ky vit që nga takimi i mëparshëm, ka shënuar ngjarje historike për Shqipërinë dhe shqiptarët.

"Festuar Ditën e Flamurit më të lirë, më të begatë, më të gëzuar e më të bashkuar se çdo vit tjetër. Më 23 qershor Shqipëria zhvilloi zgjedhjet e përgjithshme parlamentare më të mira të historisë së saj pluraliste, të lira e të ndershme dhe sipas standardeve perëndimore. Këto vlerësime nuk i japim ne, por kështu i vlerësuan vëzhguesit dhe organizatat e specializuara ndërkombëtare. Në Shqipëri sapo ka filluar punën një qeveri e re, së cilës i duhet të punojë natë e ditë për ta çuar vendin tonë gjithnjë e më përpara duke vazhduar reformat e nevojshme për zhvillimin dhe begatinë e çdo qytetari shqiptar. Ne presim besimplotë të marrim statusin e vendit kandidat në Bashkimin Evropian, bazuar në meritë, falë përmirësimit të rekomandimeve të Komisionit Evropian"-u shpreh Presidenti Nishani.

Kreu i Shtetit evidentoi gjithashtu faktin se gjatë këtij viti Kosova dhe Serbia zhvilluan bisedimet e lehtësuara nga Bashkimi Evropian dhe

e familjes së madhe evropiane.

Në këtë kuadër, Presidenti Nishani nënvizoi se Kosova, e cila ka kaluar numrin 100 të njohjeve, është bërë pjesë e nismave të rëndësishme rajonale dhe më gjerë dhe po konsolidon bashkëpunimin me Bashkimin Evropian, nëpërmjet përgatitjes së Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe zbatimit të kriterëve të kërkuara për liberalizimin e vizave.

Kreu i shtetit u shpreh se ky realitet është bërë i mundur edhe në sajë të Federatës Mbarëshqiptare "VATRA", e cila prej më shumë një shekulli ka luajtur dhe vazhdon të luajë edhe sot e kësaj dite një rol tejet të rëndësishëm për çështjen shqiptare.

"Për më tepër kontributi juaj i veçantë ka qenë ai i forcimit të lidhjeve të miqësisë dhe farkëtimit të aleancës sonë jetike e historike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me kombin amerikan, duke na shndërruar sot në aleatë të pandarë në luftën dhe përpjekjet për mbrojtjen e demokracisë dhe të drejtave të njeriut anëmbanë botës. Dhe të gjitha këto i keni bërë duke ruajtur gjuhën e bukur shqipe, traditat e kulturën tonë të rrallë dhe atdhedashurinë e qashtë e painteres për kombin shqiptar" - deklaroi Presidenti Nishani.

Presidenti Nishani ju bashkangjiti nismës së Kongresmenit shqiptaro-



Pak përpara këtij takimi, Presidenti Nishani bëri një vizitë në selinë e Federatës Mbarëshqiptare VATRA në Neë York, ku u takua dhe bisedoi me Presidentin Gjon Buçaj dhe një grup të vogël drejtuesish të kësaj organizate.

Pasi bëri një paraqitje të shkurtër të zhvillimeve demokratike dhe politike që kulmuuan me zgjedhjet e fundit të zhvilluara sipas standardeve të përparuara ndërkombëtare, Presidenti Nishani nënvizoi se kultura dhe traditat e pasura, toleranca fetare dhe besa, bashkëpunimi me fqinjët dhe rrugëtimi i pandalshëm evropian bëjnë të mbajë kokën lart çdo sh-

qiptar, në Shqipëri dhe kudo në botë.

Më herët, Kreu i shtetit u takua më anëtarë të Dhomës së Tregtisë Shqiptaro-Amerikane, me të cilët bashkëbisedoi për mundësinë e rritjes së pranisë së investimeve nga kompanitë amerikane dhe sfidat me të cilat përballlet Shqipëria për nxitjen e investimeve të huaja në përgjithësi.



arritën një marrëveshje historike, ndërkohë udhëheqësit e të dy vendeve janë takuar e kanë biseduar duke dëshmuar se rajoni ynë i ka lënë prapa njëherë e përgjithmonë mendësitë e së kaluarës së hidhur duke e hedhur vështrimin tërësisht drejt integritit të merituar në gjirin

amerikan në Asamblenë e Neë Yorkut Mark Gjonaj për krijimin e Qendrës Kulturore Shqiptare në Neë York, duke premtuar gjithashtu se, do të jetë mbështetës dhe pjesëmarrës aktiv në realizimin e këtij projekti madhor për shqiptarët e Amerikës.

tues të miqësisë dhe lidhjeve mes Shqipërisë dhe vendit më të madh të lirisë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Me suksesin tuaj na bëni të ndjehemi krenarë, sillni prosperitet për familjet tuaja dhe i jepni Shqipërisë e shqiptarëve imazhin e vërtetë".

Komuniteti shqiptar i ofron një tjetër pritje entuziaste Presidentit Nishani

Presidenti i Republikës, Bujar Nishani mori pjesë në një pritje entuziaste, të organizuar më 27 shtator 2013 për nder të Tij nga komuniteti shqiptar, ku ishin të pranishëm shqiptarë nga New York-u dhe të ardhur nga shtete të tjera të Shteteve të Bashkuara.

Në përshëndetjen e rastit, Presidenti iu drejtua të pranishmëve duke i quajtur avokatë të çështjes shqiptare dhe farkëtues të miqësisë dhe lidhjeve mes Shqipërisë dhe vendit më të madh të lirisë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Me suksesin tuaj na bëni të ndjehemi krenarë, sillni prosperitet për familjet tuaja dhe i jepni Shqipërisë e shqiptarëve imazhin e vërtetë".

META: KUVENDI TË JETË SHTËPI E PËRBASHKËT E TË GJITHËVE

Kryetari i Kuvendit, Ilir Meta, gjatë një interviste për "Tv Klan Kosova", është angazhuar për krijimin e një kulture sa më të shëndetshme bashkëpunimi, të qëndrueshëm dhe afatgjatë, midis mazhorancës dhe opozitës, në mënyrë që Kuvendi të jetë shtëpi e përbashkët e të gjithëve dhe të gjithë qytetarët të ndihen të përfaqësuar. Në funksion të një klime sa më të mirë në parlament, Meta ka vlerësuar se është shumë e rëndësishme, që "opozitës t'i jepen të gjitha mundësitë dhe hapësirat në mënyrë që të afirmojë bindjet e saj, mendimet e saj, të bëjë propozimet e saj". Duke përmendur kontributin e Partisë Demokratike në qeverisje, për anëtarësimin në NATO, për liberalizimin e vizave e për momente të tjera, kryeparlamentari tha se është shumë e rëndësishme që opozita

e re të jetë bashkëpunuese dhe kontribuese. Referuar marrëdhënjeve të Shqipërisë me ndërkombëtarët, Meta vlerësoi maksimalisht mbështetjen e dhënë nga SHBA-ja, Britania e Madhe apo vende të tjera në shërbim të çështjes shqiptare në rajon e më gjerë. "Unë jam i bindur se pa angazhimin e ndërkombëtarëve, Shqipëria nuk do të ishte kjo që është sot edhe pse shumica e shqiptarëve mendojnë se ajo duhet të ishte akoma dhe më e mirë. Kosova nuk do të ishte kjo që është sot edhe pse shumica e qytetarëve të Kosovës mendojnë që duhet të ishte më e mirë". Progresin e Shqipërisë dhe Kosovës dhe rajonit, por dhe progresin e të drejtave të shqiptarëve kudo ku jetojnë në Maqedoni, në Preshevë në Malin e Zi, Meta e lidh me forcimin e këtyre marrëdhënjeve.

CEREMONIA

Juria ndërkombëtare dhe vendore nga njerëz të artit dhe kulturës ka përzgjedhur shtatoren nga 33 bocete konkurruese

PRISHTINË, SHTATORJA E PRESIDENTIT HISTORIK IBRAHIM RUGOVA NË SHESHIN ME EMRIN E TIJ

Kosova nderoi më 27 shtator Presidentin historik, Ibrahim Rugova, me ngritjen në "fron" në sheshin me emrin e tij të Shtatores, në një ceremoni solemne shtetërore, pasi mbërriti nga Tirana në Prishtinë vepra e skulptorit tiranas, Julian Muçollari, e gjatë 4.25 metra.

Presidentja e Republikës, Atifete Jahjaga, dhe kryetari i komunës së Prishtinës, Isa Mustafa, në fjalimet e tyre e vlerësuan Presidentin historik Rugova arkitekt të Pavarësisë së Kosovës.

Pjesëmarrësit e shumtë nga insitucionet shtetërore dhe spektri politik, si dhe mijëra qytetarë, kanë përkujtuar se që para më shumë se dy dekadave, Rugova hapur përcaktonte pozicionin gjeopolitik kosovar dhe shpallte idenë për shtet, duke theksuar se "zgjidhja më e mirë është Kosova e pavarur e neutrale, e hapur ndaj Shqipërisë e Serbisë dhe një administrim civil ndërkombëtar si fazë kalimtare".

Në Kosovën e sulmuar e okupuar nga forcat serbe të kasapit të Ballkanit, Slobodan Miloshevic, lideri i lëvizjes paqësore e aktive për liri, pavarësi e demokraci, Rugova, kërkonte "mbrojtje ndërkombëtare për Kosovën dhe popullin e saj dhe

të ndalohet përhapja e konfliktit në rajon".

Pas vitesh e zhvillimeve historike, luftës, masakrave e gjenocidit, ndërhyrjes shpëtimtare të NATO-s e vendosjes së protektoratit ndërkombëtar të OKB-së, pas zgjedhjeve para në Kosovën e lirë, duke u inaguruar në Parlamentin e Kosovës president i pas zgjedhjeve të paracionale të pasluftës, Rugova, në 4 mars 2002, thoshte: "çdo ditë ne të gjithë duhet të zgjohemi me një mendim të bukur: çfarë të mire mund të bëjmë sot për Kosovën?".

Pavarësia e Kosovës, në të mirë të gjithë qytetarëve të saj, dhe si i vetmi kompromis, theksohej e rithekshej vazhdimisht nga Rugova edhe në Kosovën e lirë nga pranvera e vitit 1999.

"I vetmi kompromis për Kosovën është pavarësia, dhe ky është optimumi i gjithë shqiptarëve në rajon", thoshte shumë prerë Ibrahim Rugova më 6 tetor 2005, në takim me Grupin Negociator, formimi i të cilit ishte një moment me shumë rëndësi për unitetin në vend si dhe për bisedimet për statusin e Kosovës të udhëhequra nga i dërguari i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Presidenti Martti Ahtisaari, e pastaj edhe nga Treshja SHBA-BE-Rusi në an-

gazhimet shtesë.

Zyrtarë të Prishtinës kanë thënë se juria ndërkombëtare dhe vendore nga njerëz të artit dhe kulturës ka vlerësuar dhe përzgjedhur shtatoren nga 33 bocete konkurruese.

Sheshi i Pavarësisë Ibrahim Rugova në Prishtinë, prej sot me shtatoren e arkitektit të Pavarësisë së Kosovës, përballë selive të Presidencës, Kuvendit, dhe të Qeverisë kosovare, ku është edhe shtatorja e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, ka nisur të ndërtohet në marsin e vitit të kaluar.

Pak ditë pas 17 Shkurtit historik 2008, të shpalljes së shtetit të Kosovës, patën nisur përgatitjet dhe punimet për lirim dhe hapësirë të paraparë për Sheshin. Fillimisht janë rrënuar disa objekte, që kryesisht shfrytëzoheshin nga tregtarët dhe zejtarët, e që nuk kishin ndonjë rëndësi të trashëgimisë kulturore e historike.

Ndërsa, po aty, në qendër të Prishtinës, si pjesë e sheshit, është rinovuar një ndërtesë që dikur ishte hotel, një kohë me emrin Skënderbeu, projektuar nga një arkitekt austriak dhe ndërtuar në vitin 1927, e cila paraqet vlerë të arkitekturës dhe kulturës evropiane të fillimshkullit XX.

B.Jashari



Thaçi: Në Veriun e Kosovës ka ende elementë që duan trazira



Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, i ndodhur në Nju Jork për takime me udhëheqës ndërkombëtarë, i tha "Zërit të Amerikës" se, zgjedhjet komunale të 3 nëntorit do të hapin një kapitull të ri për normalizimin e plotë të gjendjes në Veriun problematik të vendit. Zoti Thaçi tha se kushtet për zgjedhje në Veri ekzistojnë, pavarësisht se ka elementë që, siç u shpreh ai, kërkojnë trazira dhe përipiqen të frikësojnë qytetarët. Në komentet që bëri për "Zërin e Amerikës", Kryeministri Hashim Thaçi tha se, dëshironte të na jepte një lajm të mirë, se kishte marrë personalisht konfirmim për njohje të reja të shtetit të Kosovës. "Është konfirmuar njohja edhe prej dy vendeve të reja, nga shteti i Grenadës dhe nga Kryeministri i Libisë. Në dy takimet që kam zhvilluar janë konfirmuar njohjet edhe zyrtare prej këtyre dy shteteve. Deri tani, Kosova është njohur nga 103 vende dhe presim edhe të tjera në ditët e ardhshme", tha Kryeministri Thaçi. Por qeveria e zotit Thaçi përballet me një sfidë të vështirë, zgjedhjet komunale në Veri, të cilat janë pjesë e zbatimit të marrëveshjes mes Kosovës dhe Serbisë të arritur në muajin prill në Bruksel. "Ka kundërshtime, por ka edhe angazhime për një konkurrencë të shëndoshë politike. Për herë të parë po organizohen zgjedhje lokale në Veri të vendit, ku edhe ato katër komuna do të integrohen në Kosovë dhe ata qytetarë të Kosovës do të marrin pjesë në zgjedhje për herë të parë sipas standardeve evropiane dhe në përputhje të plotë me legjislacionin kosovar. Jam shumë optimist se, pas 3 nëntorit do të hapet një kapitull i ri për Kosovën, kapitulli evropian, një kapitull i normalizimit të plotë të gjendjes në Veri", tha Kryeministri Thaçi. Por, vrasja e një pjesëtari të Eulex-it kohët e fundit në Veri, i ka shtuar shqetësimet se gjendja atje mund të mos jetë e përshtatshme për zgjedhje. Zoti Thaçi tha se, nuk mendon kështu: "Në Veri janë të përshtatshme kushtet për zgjedhje, por ende ka elementë që nuk duan zgjedhje, ende ka elementë që duan trazira, që duan të frikësojnë qytetarët. Por atje do të ngadhënjëj demokracia, do të ketë zhvillim ekonomik, investime dhe do të hapet një kapitull i ri, kapitulli evropian", tha Kryeministri Thaçi. Në komentet për "Zërin e Amerikës", zoti Thaçi nuk u vuri rëndësi disa lëvizjeve brenda partisë së tij, që kanë çuar në nisma të reja politike, të cilat po mbështeten edhe nga njerëz, më parë shumë të afërt me të, si kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi dhe ish-zëvendësi i tij, Fatmir Limaj. Zoti Thaçi tha se, partia e tij do të arrijë fitore bindëse në zgjedhje: "Konkurrenca e vlerave-dhe Kosova tashmë është mësuar me këtë konkurrencë tash 15 vite - i ka dhënë një mesazh të plotë shëndetit të politikës kosovare, prandaj Partia Demokratike e Kosovës është dhe mbetet partia më e madhe dhe partia fituese në zgjedhjet e ardhshme", tha Kryeministri Thaçi.

KOSOVA MERR PREMTIME PËR NJOHJE NGA BOTSUANA DHE SUDANI I JUGUT

Kosova merr premtime për njohje nga Botsuana dhe Sudani i Jugut, një ditë pas njoftimeve zyrtare për njohje nga dy shtete, Libia e Grenada dhe arritjes në 103 të numrit të vendeve anëtare të OKB-së që kanë njohur pavarësinë e shpallur në 17 Shkurtin historik 2008.

Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj, gjatë qëndrimit në Nju Jork, ku u mbajt sesioni i 68-të i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, u takua me ministrat e Punëve të Jashtme të Botsuanës dhe Sudanit Jugor, ku ka kërkuar njohjen e Kosovës nga këto dy shtete.

Në njoftimin zyrtar të MPJ-së kosovare dërguar nga Nju Jorku bëhet e ditur se pas vizitës zyrtare që ministri Hoxhaj ka zhvilluar në Botsuana në mars të këtij viti, takimi me ministrin e Jashtëm dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Botsuanës, Phandu T.C Skelemani në Nju Jork, konfirmoi qëndrimin se njohja e Kosovës nga Botsuana është çështje procedurash. Gjatë takimit, Hoxhaj e informoi homologun nga Botsuana për progresin që po arrihet në



shtetin e Kosovës, me theks të veçantë për fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar.

Ministri Hoxhaj foli edhe për avancimin e vazhdueshëm të procesit të njohjeve, përfshirë vendimin e Grenadës dhe Libisë për njohjen e Kosovës, dialogun me Serbinë, stabilitetin politik dhe ekonomik, si dhe gatishmërinë e Prishtinës për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.

Ministri i Punëve të Jashtme i Botsuanës, Phandu T.C Skelemani e përgëzoi ministrin Hoxhaj për pro-

gresin në shtetndërtimin e Kosovës.

Ministri Enver Hoxhaj gjatë ditës është pritur në takim në Misionin Permanent të Sudanit të Jugut në Kombet e Bashkuara, nga ministri i Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të këtij shteti, Barnaba Marial Benjamin.

Gjatë takimit, ministri Hoxhaj kërkoi njohjen e Kosovës nga vendi më i ri në botë, duke theksuar se ndërmjet Kosovës dhe Sudanit të Jugut ekzistojnë ngjashmëri në kauzën e përbashkët si dy shtete të lira.

Hoxhaj theksoi se Kosova gëzon simpati për Sudanin Jugor dhe është e gatshme të ndihmojë në shumë fusha, përfshirë bujqësinë dhe veterinarinë, edukimin, teknologjinë informative etj.

Ministri i Jashtëm i Sudanit Jugor, Barnaba Marial Benjamin, konfirmoi që njohja e Kosovës është çështje kohe. Ai po ashtu e ftoi ministrin Hoxhaj për vizitë zyrtare në Sudanin e Jugut, në dhjetor të këtij viti.

JUBILARE

Shkalla e respektit për historinë tregon dhe nivelin e emancipimit të një populli

Një 70 vjetor për ata që mbetën gjithmonë të rinj

• Shtabi i qarkut të Beratit kishte vendosur qëbatalioni "Margarita Tutulani" të organizohej në Qershor 1943. Për arësye të aktivitetit luftarak, inaugurimi i kësaj ngjarje u realizua më 20 shtator të po atij viti, në lulishten e qytetit të Beratit, tashmë të çliruar mbas kapitullimit të Italisë. Pikërisht në këtë vend, me mbarimin e luftës, u ngrit një lapidar në përkujtim të kësaj ngjarje



Nga Skënder MALINDI

Historia, në rrafshin aka demik, është një shkencë e saktë, është një kronikë në kohë e ngjarjeve të një populli. Por ka dhe një aspekt njerëzor të saj, që nuk ka të bëjë me letrat e shkruara, Bëhet fjalë për "shkrimet" në ndërgjegjen dhe kujtesën e njerëzve, në respektin që tregojnë për të kaluarën, me të mirat dhe të këqijat e saj. Në një farë mënyre, shkalla e respektit për historinë tregon dhe nivelin e emancipimit të një populli. Dhe në këtë aspekt mendoj, nuk është se mund të krenohemi shumë.

Nga ana ime, ndjej një detyrim moral, që si dëshmitar dhe protagonist të kujtoj një moment të veçantë të luftës, atë të formimit të Batalionit të Rinisë të qarkut të Beratit "Margarita Tutulani". Ky gjest modest është minimumi që mund të bëhet për ata njerëz të thjeshtë, që pa bujë dhe poza heronjsh sakrifikuin ekzistencën e tyre për një besim.

Lufta për një besim, në rrethana ekstreme, i shndërron njerëzit anonimë në emra ngjarjesh. Janë këto që krijuan atë plejadë dëshmorësh, akti vetmohues i të cilëve, i bën të barabartë përpara historisë.

Shtabi i qarkut të Beratit kishte vendosur që ky formacion të organizohej në Qershor 1943. Për arësye të aktivitetit luftarak, inaugurimi i kësaj ngjarje u realizua më 20 shtator të po atij viti, në lulishten e qytetit të Beratit, tashmë të çliruar mbas kapitullimit të Italisë. Pikërisht në këtë vend, me mbarimin e luftës, u ngrit një lapidar në përkujtim të kësaj ngjarje.

Në ceremoninë e inaugurimit të batalionit mori pjesë gjithë populli i Beratit, si dhe drejtuesit e shtabit të këtij qarku. Fjalën e rastit e mbajtën Gjin Marku, Mestan Ujaniku dhe Kahreman Ylli.

Në planin organizativ aty u inkuadruan çetat e të rinjve partizane nga Berati, Kuçova, Lushnja dhe Fieri. I gjithë ky kontigjent arrinte në rreth 250 partizanë të moshës 18-21 vjeç. Siç vetëkuptohet, falë moshës, karakterizoheshin nga shkathtësia, veprimet energjike, fryma sulmuese si dhe nga aftësia përballuese e sakrificave dhe rrethanave sado të vështira.

Në këtë ceremoni festive, batalionit iu vu emri i Heroinës së Popullit "Margarita Tutulani". Gjithashtu, nga ana e shtabit të qarkut, u përcaktuan objektivat strategjike si dhe teatri i veprimeve luftarakë, të cilat, gjykuar në një distancë kohore, u realizuan me sukses deri në çlirimin e vendit.

Zona operative përfshinte rajonet Paraspuar-Therpep-Spathare-Tenda e Qypit si dhe vargmali i Qarrishtës. Ky terren krejtësisht malor, me lartësi mbi 1500 m mbi nivelin e detit, ishte objektivi kryesor i operacioneve të armikut. Qëllimi i tyre ishte, asgjësimi i rezistencës partizane në rethin e Skraparit, që ishte dhe qendra kryesore në qarkun e Beratit ku strehohej Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë partizane. Ky rajon me rëndësi nevralgjike, i cili iu besua batalionit "Margarita Tutulani", u bë arena e shumë luftimeve dhe përleshjeve mjaft të ashpra.

Në epopenë e luftës, veçohen për nga rëndësia, disa beteja kulmore me pjesëmarrjen e Batalionit të Rinisë. Ndër to ishte lufta për mbrojtjen e Beratit më 15 Nëntor 1943. Së bashku me Batalionin "Antonio Gramshi", u ndeshëm me forcat naziste gjermane, ku ranë dëshmorët partizanë Irfan Shehu, Arif Myftari dhe Zoi Mitrushi.

Lufta në fshatrat Lubeshe dhe Kapinove të Beratit në nëntor 1943

Këtu qëllimi ishte nxjerrja nga rrethimi i shtabit të qarkut të Beratit si dhe i 30 amerikanëve. Më pas vijojnë lufta në Tendën e Qypit ku ra dëshmor komisari i batalionit, Ajet Xhindole "Hero i Popullit", lufta e Paraspuarit më 2 mars 1944, ku ranë dëshmorë, komandanti i kompanisë,



trimi Mak Dashi, partizanët Nesim Kuçi (Vendresha) dhe Petrit Lulo.

Më tej, batalioni u inkuadrua në Brigadën e VII-të S, duke kryer luftime të njëpasnjëshme nga Velusha deri në Vishegrad.

Një veçanti e batalionit "Margarita Tutulani", qëndron tek përbërja e tij, kryesisht nga rinia beratase. Natyrisht që nga ky qytet, kanë dalë shumë luftëtarë që luftuan në shumë formacione të ndryshme partizane, por me të drejtë kjo njësi është përfaqësuesja më e denjë e kontributit të këtij qyteti.

Mund të thuhet me plot gojën që lavdia e Beratit, sakrificat e tij për çlirimin e atdheut, sintetizohet tek këta të rinj. Ky vetmohim bëhet më i dukshëm, po të kujtojmë se i tërë ky kontigjent përbëhej nga qytetarë të

pamësuar me jetën e vështirë që të impononte lufta në male. Kjo ishte një odise e gjatë sprovash, privimesh dhe ndeshjesh me vdekjen dhe kushtet ekstreme të natyrës. Me dinjitet, thjeshtësi dhe pa pretendime, ata u treguan të denjë për lartësinë e kauzës për të cilën po sakrifikonin.

Dihet që luftat kanë një çmim shumë të shtrenjtë. Ata kërkojnë shumë jetë, shumë gjak. Dhe nga më i miri bile. Liria kërkon kurbanët e saj, dhe sa më të shumtë janë ata, aq më vlerë ka ajo.

Në këtë altar, si të barabartë mes të barabartëve janë Ajet Xhindole "Hero i Popullit", Zenel Baboçi, Irfan Shehu, Arif Myftari, Zoi Mitrushi, Karafil Guma, Mak Dashi, Nesim Kuçi (Vendresha), Petrit Lulo,

Dervish Dule, të cilët do të ndiqeshin nga të tjerë, të rënë në luftimet e Brigadës së VII-të Sulmuese.

Kujtimi i tyre, i emrave, ngjarjeve dhe shkaqeve, përtej një shprehje respekti dhe mirënjohje, është dhe një dimension aktual. Shërbimi më i keq i historisë, është kur ajo shihet vetëm si diçka muzeale, një grumbull fotosh apo datash të pluhurosura. Në realitet ajo është e gjallë, me të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen, të pandara. Rrethanat e saj ndryshojnë, por liria, pavarësia, dinjiteti njerëzor, si dhe përpjekjet për ti pasur ato janë po aq të lashta sa dhe jeta. Prandaj çdo histori, sado e vjetër qoftë, është dhe profetike.

*Ish komandant i batalionit të rinisë batalionit "Margarita Tutulani"



Një vit më parë ra në krye të detyrës, si drejtues i mjetit të Sigurisë së Presidentit të Republikës

Rekuiem për ish gardistin shembullor Arben Zhuzhi

Nga Valsin TANELLARI

Një vit më parë, më 14 shtator 2012, ish punonjësi i Gardës së Republikës, Arben Zhuzhi humbi jetën në një aksident në krye të detyrës, si drejtues i mjetit të Sigurisë së Presidentit të Republikës.

Të shtunën e këtij 14 shtatori atë e përkujtuan me nderim të veçantë familja dhe të afërmit si dhe ish kolegët e tij të shërbimit të Gardës. Një ceremoni përkujtimore mbresëlënëse në një nga sallat e Hotel "Tirana" ku mes qindra pjesëmarrësve ishte i pranishëm edhe kreu i Gardës së Republikës Artan Hoxha. Një certifikatë mirënjohjeje për të ndjerin Arben Zhuzhi nga kryegardisti flet shumë për vlerësimin që shteti iu bëri "rojtarëve" të sigurisë së autoriteteve të tij.

Një dokumentar i publicistit të mirënjohur Defrim Methasani u ndoq me vëmendje të veçantë nga pjesëmarrësit në këtë tubim përkujtimor në nderim të ish punonjësit të Gardës së Republikës të rënë në krye të detyrës. Njeriu që flet me mungesën e tij "ringjallet" nëpërmjet këtij dokumentari ku jepen gjer në perfeksion detaje nga jeta dhe akti heroik i djaloshtit dibran.

Për herë të parë këtë fillim shtatori, skenaristi, kronikani dhe op-

brës. Stacioni i tyre i parë, fshati Dovolani, një fshat i madh e i bukur, plot gjelbërim, ku lindi Arbeni, me 30 qershor të vitit 1964. Prindërit Ganiu dhe Fatmira, bëhen me fletë për këtë dhuratë të Zotit dhe më pas familja shkon në Peshkopi ku jeton për vite e vite me radhë. Qyteti i blirëve ku vazhdon edhe studimet në të gjitha ciklet ishte vendi më i bukur për Benin.

Dokumentari paraqet më pas gjimnazin e qytetit, njëri prej autorëve më të mira në Shqipëri. "Pikërisht në këtë klasë dhe në këtë bankë ulej djaloshi simpatik që shndriste krahas shumë të tjerëve, duke fshehur si asi nën mëngë, aftësitë dhe idete e tij, për të qenë njeriu i makinave. Më poshtë qendrës, ndodhet lagjja, ku jetonte Beni. Duke u rritur moshën, rritej edhe dëshira e tij, për të patur njeriun e ëndrrave e cila ishte një vajzë që përveçse bukurisë fizike, kishte edhe themelet e forta, ato të familjes Ndreu, që i përkiste sojit të Elez Isufit. Te ai pallat dhe ato stola, fërshellimat e tij, do të linin pa gjumë Luljeten e cila u tundua shumë prej dashurisë së Benit. Vajza e Rexhep dhe Naxhije Ndreut, që vijonte studimet në univeristetin e Tiranës, do të pranonin të ishte nusja e tij dhe në vitet 88-89, vjen edhe kurorëzimi i të rinjve, me fejesën e tyre. Pas kaq vitesh, ajo kujton me nostalgji dhe mallëngjim njëherësh këtë

lartëson sot familja e tij, bashkëshortja e nderuar Leta dhe fëmijët, qindra të pnaishmit në këtë ceremoni përkujtimore derdhi lotë dhimbjeje. Të imponon lotët kronika e asaj dite të zezë, që njoftonte një lajm të kobshëm. Një rekuiem për ish gardistin shembullor Arben Zhuzhi

E pabesueshme, por ai që prej të gjithëve njihej si pilot, kish ndërruar jetë.

"Bashkëshortja, Leta e konsideronte një dhimbje të dyfishtë ikjen e tij, ndaj në këtë udhëtim në qytetin e Peshkopisë, ajo ndalesën e shpirtit e ka te varri i vjehrrit, Ganiut (ish oficer me emer e zë), bashkë me fëmijët e saj. Një lule, më shumë se një kujtesë, një respekt vlerash për të atin e shpirtit binjak të saj, Arbenit.

Në Peshkopi lindi Briselda, me 14 shtator të vitit 1991, gëzimi dhe hareja e parë e çiftit, që ndryshoi gjithçka në jetën e tyre. Ndërsa tre vjet më pas, me 4 qershor të vitit 1994, vjen në jetë vajza e dyte, Esmeralda. "Yjet e babit", siç i quante Beni, ndrisnin shtëpinë dhe e mbushnin plot gezim.

Në vitin 1995, ai familjarisht la qytetin e Peshkopisë dhe erdhi të banonte në një pallat, në Laprakë në Tiranë. Këtu erdhën shumë gjëra të mira, por kryesorja, ishte lindja e djalit të vetëm të tij, siç e quajti ai që nga dita e lindjes me 12 prill të vitit 2001,



sisht për familjen e ish gardistit shembullor, pjesëmarrësit në këtë ceremoni përkujtimore shprehin vlerësime maksimale për bashkëshorten Letën, dy vajzat Briselda e Esmeralda dhe për Arbërin 13-vjeçar që lartësojnë aq shumë emrin e Arben Zhuzhit, duke e veshur me pavdekësi.

Arbeni ishte i miri i të gjithëve, gojëmbël e hokatar. Humbja e tij, kalonte kufijtë e normales, për bashkshorten dhe tre vjet. Plagë në zemër është edhe për nënën e shtrenjtë të tij, që e zeza nuk i ndahet, për motrën e dy vellezërit e tij, që e deshën aq shumë dhe nuk vinin askend mbi Benin.

Në Gardën e Republikes, në këtë institucion të mbrojtjes së vlerave institucionale dhe personaliteteve të shtetit, u personifikua personaliteti dhe vlera e Arben Zhuzhit. Që nga 1 maji i vitit 2001, në ditën e parë të punës e deri në ditën e ikjes nga kjo jetë, ai ishte shoferi dhe njeriu perfekt, që e deshën të gjithë. Siç shprehet Methasani, realizuesi i këtij dokumentari shumë original "ëndrra e tij, ishte të drejtonte mjetin e sigurisë së lartë të Presidentit të Republikës dhe këtë e bëri realitet. Dy njerëz, kanë dy

merita tek ëndrra e tij: Arben Çuko që firmosi futjen e tij në gardë dhe Artan Hoxha që mundësoi kalimin e tij, në grupin e shoqërimit të Presidentit Nishani, në shtator të vitit 2012. Pas një rruge në Kosovë, ku la shume kujtime dhe mbresa, në nisjen e tij të dytë drejt Ohrit, vjen fati i zi, kur humbi jetën në një aksident në krye të detyrës, si drejtues i mjetit të Sigurisë së Presidentit të Republikës.

Arben Zhuzhi iu përket atyre njerëzve që falë sakrificës së tyre hyjnë në histori të veshur me pavdekësi. Së bashku me bashkshorten e nderuar, Letën (edhe kjo intelektuale e mirëfilltë e përkushtuar ndaj vlerave të demokracisë) krijuan një familje dinjitoze, një vatër të ngrohtë, respekti dhe mikpritje. Ai ishte sinteza e cilësive fisnike. Gjatë gjithë jetës së tij, ka qenë njeri i thjeshtë, i ndershëm, i respektuar, gojëmbël, i papërtuar, njeri i mikpritjes, i dashur me të gjithë miqtë e bashkëpunëtorët. Si i tillë ai njihet nga të gjithë.

Zakonisht në të tilla ceremoni, gjithkush për të ndjerin flet fjalë të mira, por rrallë ndodh që gjithkush të përjetojë vlera dhe mirësi nga vetë ceremonia. Natyrisht, është vlerë numri aq i madh i njerëzve në këtë tubim përkujtimor të një njeriu fisnik që diti të orientohet mirë në jetë dhe t'i përgjigjet jetës me dinjitet, me burrëri dhe fisnikëri.



eratori i talentuar D.Methasani, sëbashku me njerëzit e familjes Zhuzhi kanë udhëtuar pa Benin, tashmë drejt vendlindjes së tij, Di-

njuhje të parë...". Ndërsa në ekran jepen grimca nga jeta dhe vepra e Arben Zhuzhit, të cilën më shumë se kushdo po e

kampion. Ky ishte Arbëri, që pafundesisht e donte dhe çmendej pas tij...". Ndërsa dokumentari flet hollë-

Konferencë shkencore me rastin e 100-vjetorit të rezistencës së dibranëve kundër serbëve

Testamenti i atdhedashurisë

Nga Halil RAMA

Shprehja e përbotshme "atdheu fillon te familja" është referencë e qindra kuvendeve, takimeve tryezave, sesioneve e konferencave shkencore. 100 vjet më parë qyteti i Dibrës dhe ai i Gjakovës ishin koncesionet e fundit që iu bënë monarkive të shteteve fqinje, që kishin pushtuar me forcën e armëve viset shqiptare gjatë luftërave ballkanike. Kjo padrejtësi historike u vendos në Konferencën e Londrës (1913), ku u caktuan kufijtë e shtetit shqiptar. Pikërisht kur po caktoheshin dhe kufijtë, u ndanë dhe dy Dibrat, ndërsa dibranët përjetuan gjenocidin e pashembullt serb e për rrjedhojë edhe eksodin e parë masiv, ku 80 mijë dibranë u detyruan të shpërnguleshin nga trojet e tyre në Dibër për t'u vendosur në Tiranë. Lanë një pjesë të vatanit, por sërish me familjet e tyre gjetën strehë në një pjesë tjetër të atdheut.

Pikërisht 100-vjetori i rezistencës së dibranëve kundër serbëve dhe i eksodit të tyre drejt Tiranës u përkujtuuan këto ditë gjatë një konference shkencore që u mbajt në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë.

E nisëm me atdheun për të evidentuar pikërisht ata që e kanë më të zjarrtë se askush tjetër ndjenjën e atdhedashurisë, si organizatorët kryesorë të këtij tubimi përkujtimor. Dhjetëra personalitete të shquara të diasporës shqiptare në SHBA, me origjinë nga Dibra, qenë jo vetëm nismëtarë, por dhe organizatorë, sponsorë e referues në këtë event të rëndësishëm.

Një përsëritje mjaft emocionuese në emër të komunitetit dibran nga Musa Pacuku, kryetar i shoqatës "Dibra" me seli në të ashtuquajturin "Ishulli i Dibranëve" Staten Island (Nju-Jork), ishte mjaft mbresëlënëse për qindra pjesëmarrësit në këtë konferencë shkencore.

Ylber Piku, një tjetër personalitet i njohur i diasporës shqiptare në SHBA, do të evidentohet jo vetëm si pjesëmarrës aktiv, por dhe si organizator e sponsor kryesor i këtij aktiviteti. Billy, siç e njohin të gjithë Ylber Pikun, ndihet më krenarë se kurrë që mbështet financiarisht aktivitetin e Shoqatave "Dibra" (SHBA) dhe "Bashkësia Dibrane" (Tiranë) si vazhdimësi historike të klubit atdhetar "Bashkimi Dibran", themeluar në Dibër më 26 dhjetor të vitit 1908, me qëllim zgjimin e ndjenjave kombëtare dhe mbrojtjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare si rezistencë ndaj pushtimit. Kjo shoqatë i ka rrënjët e saj në lëvizjet patriotike dhe kombëtare, të cilat filluan të organizoheshin para shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, ku klubi atdhetar "Bashkimi Dibran" nga ku shoqatat "Dibra" (SHBA) dhe "Bashkësia Dibrane" (Tiranë) kanë marrë këtë emërtesë, patën rol kryesor në rizgjimin e krenarisë kombëtare, patriotike, për të mbrojtur vendin e tyre kundër pushtuesit, duke i shërbyer heshtjes kombëtare dhe përhapjes së gjuhës shqipe. Organizator i takimit ishte dhe Unioni i Krijuesve dhe Gazetarëve Dibranë, me president Fatos Dacin.

Pikërisht këtij qëllimi madhor i shërben edhe sot kontributi i Musa Pacukut e Ylber Pikut, që u evidentuan dukshëm në këtë 100-vjetor të kryengritjeve dibrane kundër shovinistëve serbë, së bashku me veprimtarin e dalluar të këtij komuniteti, zotin Rrape Ruci, i cili njëherësh është dhe president i institutit amerikano-shqiptar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" me seli në State Island. Mbresëlënëse ishte edhe interpretimi i një poezie të poetit tonë të madh Lasgush Poradeci nga aktori shqiptar nga Çikagoja, Pajazit Murtishi.

Dibra dhe dibranët janë të hershëm në histori si emër dhe si princa.



Ja edhe dibranët e Amerikës vijnë si princa në atdheun e tyre me ndjenja të bukura, të frymëzuara dhe interesante. Vijnë më të mbushur së kurrë më ndjenja atdhetare dhe meditative që burojnë nga zjarri i zemrës së një shpirti të trazuar. Kulti i mërgimitarit është respekti ndaj kombit. Përjetimet, përkushtimet dhe krijimet janë të mbrujtura me ndjenjat fisnike të atdhedashurisë. Ëndrra e tyre është Shqipëria historike, me Çamërinë në Jug, me trungun e atdheut në zemër dhe me Kosovën në Veri.

Së bashku ata përcollën denjësisht testamentin e atdhedashurisë. Këtë testament tejet të vlefshëm, që e ruajnë me fanatizëm në SHBA, ku ata punojnë e jetojnë prej dekadash. Jo vetëm me fjalë, por me vepra konkrete ata dëshmojnë se atdheu i tyre fillon tek vetja, familja, shoqëria e kombi.

Atdhe abstrakt e hyjnor nuk ka e nuk ekziston. Këtë sentencë e shtjelluan më së miri në kumtesat e tyre prof. dr. Valentina Duka, historianët e mirënjohur Gazmend Shpuza e Bajram Xhafa. Ata nxorën në pah para të pranishmëve heroizmin, vendosmërinë dhe rezistencën e dibranëve për të mbrojtur vendin e tyre nga çdokush që synon të cenojë të

drejtat dhe kufijtë e tyre gjeografikë. Për të qenë sa më bindës, ata sollën në kujtesë edhe një raport të hollësishtëm të një diplomat të huaj, ambasador i një shteti perëndimor, për mizoritë e ushtrisë serbe në Dibër, Strugë, Kërçovë, gjatë operacionit për shtypjen e kryengritjes antiserbe të vitit 1913, kur kryengritësit shqiptarë të Dibrës, Strugës, Ohrit, Kërçovës, Gostivarit arritën t'i dëbonin trupat serbe deri në malet e Manastirit. Rrallë ndonjëherë mund të gjendet një material me të dhëna aq të sakta e të hollësishme jo vetëm për vrasjet dhe masakrimin e njerëzve, por dhe për grabitjen e pronës dhe të pasurisë.

Dibra ka nxjerrë burra të rrallë, që u shndërruan në personalitete të shquara të vendit tonë, si Vehbi Dibra, Haki Sharofi, Isuf Elezi, Iljaz Dibra, Dine Hoxha etj. Ata u përkujtuuan me respekt dhe nderim të veçantë në këtë konferencë shkencore.

Një të njëjtën linjë ishte edhe përsëritja e zjarrtë e kryetarit të Shoqatës "Bashkësia Dibrane", dr. Faruk Borova, i cili ndër të tjera nxori në pah vlerat më të larta të dibranëve si dhe bujarinë dhe mikpritjen e tiranase, të cilët i hapën portat e shtëpive dhe zemrave të tyre dibranëve, pikërisht

ishtë në atë kohë kur ata kishin më së tepërmi nevojë. Ai gjithashtu përmendi faktin se si dibranët emigruan drejt Tiranës dhe jo drejt një qyteti tjetër, mos ndoshta me parandjenjën se Tiranë do të kishte këtë zhvillim që ka tani dhe do të bëhej kryeqendra e Shqipërisë.

Ai falënderoi në mënyrë të veçantë të gjitha ato familje tiranase të asaj kohe që mikpritën me shumë dashuri dhe bujari dibranët, të cilët të detyruar nga shovinizmi dhe reprezaljet serbe morën rrugën e mërgimit, pa e ditur se ku do të përfundojnë. Dr. Borova përmendi dëmet e shumta të agresionit serb si: me mijëra njerëz të vvarë, burra, gra, pleq e fëmijë, me mijëra shtëpi, xhami e teqe të djegurra e të shkatërruara. Pikërisht këto ishin ndër shkaqet më kryesore që detyruan më shumë se 20 mijë dibranë të emigrojnë drejt qyteteve të tjera të Shqipërisë, por edhe jashtë saj, por kryesisht në Tiranë, e cila në atë kohë përbehej nga 8000 banorë.

Ndoshta edhe për këto fakte pjesëmarrësit vlerësuan praninë në këtë konferencë të rëndësishme të kryetarit të shoqatës "Tirana", Arben Tafaj.

Në këtë aktivitet morën pjesë anëtarë të familjeve të vjetra dibrane, personalitetet të shquara dibrane veprimtar dhe aktivist dibranë që prej vitesh jetojnë në Shqipëri, kryeqytetin e shqiptarëve, Tiranën. Ndërkohë një grup (30 veta) intelektualësh dibranë, veteranë të arsimit, profesorë dhe arsimitarë me ndihmën financiare të veprimtarit dhe biznesmenit të suksesshëm dibran në SHBA, Ylber Pilku, nga kompania "Pilku Construction" në Nju-Jork, udhëtoi drejt Tiranës, për të marrë pjesë në këtë konferencë, kushtuar 100-vjetorit të kryengritjes së përgjithshme të Dibrës dhe eksodit të parë masiv dibran në Tiranë dhe Elbasan.

Së bashku ata përcollën me dinjitetin testamentin e atdhedashurisë.

"Dibranë dhe tiranase, 100 vjet së bashku"

Para tre muajsh, Shoqata "Bashkësia Dibrane" në bashkëpunim me shoqatën "Tirana", nën kujdesin e Bashkisë së Tiranës, si dhe me mbështetjen e Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam, promovoi librin "Dibranë dhe Tiranase 100 vjet së bashku" të autorit Dr. Faruk Borova. Ky libër vjen para publikut shqiptar me rastin e 100 vjetorit të eksodit të dibranëve. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin: Kryetari i Bashkisë së Tiranës z. Lulzim Basha, Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe z. Ruzhdi Lata, Kryetari i shoqatës "Tirana" z. Arben Tafaj, përfaqësues të fushës politike, përfaqësues të institucioneve të ndryshme shtetërore dhe joqeveritare, miq, të afërm, bashkëpunëtorë dhe dashamirës të Dr. Farukut, dibranë dhe tiranase, etj.

Kz libër evidenton vlerat më të larta të dibranëve, si dhe bujarinë dhe

mikpritjen e tiranaseve, të cilët i hapën portat e shtëpive dhe zemrave të tyre dibranëve, pikërisht në atë kohë kur ata kishin më së tepërmi nevojë.

Dr. Borova nga fundi i librit, përmend shembullin e dy të rinjve dibranë dhe tiranase në vitin 2030, ku vetëm ata të dy do ta dinë se nga e kanë prejardhjen, pra cili prej tyre është tiranase dhe cili dibran, ndërsa të tjerët as që kanë për ta kuptuar. E gjithë kjo ndodh për shkak të shkrirjes dhe gërshtimit të të gjitha dallimeve në një të vetme.

Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe z. Ruzhdi Lata, falënderoi në mënyrë të veçantë të gjithë ato familje tiranase të asaj kohe, të cilët mikpritën me shumë dashuri dhe bujari dibranët, të cilët të detyruar nga shovinizmi dhe reprezaljet serbe morën rrugën e mërgimit, pa e ditur se ku do të përfundojnë. Z. Lata shtoi: "Kur vijmë në Tiranë, na duket

sikur vijmë në shtëpinë tonë të dytë, sepse Tiranën e konsiderojmë "nënë e madhe" të të gjithë shqiptarëve anëkënd botës".

Kryetari i Shoqatës "Tirana" z. Arben Tafaj, përmendi faktin e përshtatjes së të dy komuniteteve në shumë drejtime, si në traditat e ndryshme, lidhjen e martesave mes të dy komuniteteve, bashkëpunimin e frytshëm, etj.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Lulzim Basha, i cili edhe ai falënderoi familjet autoktone tiranase për mbështetjen e madhe dhe të pashlyeshme që i ofruan dibranëve gjatë kohës së eksodit të vitit 1913. Ai tha gjithashtu se ishte nip dibrë, megjithatë veten e ndiente dhe konsideronte si djalë dibrë. Ai nuk la pa cekur edhe punimet që bëhen për "Rrugën e Arbrit" e cila në një afat kohor



shumë të shpejtë do të përfundojë dhe do të lidhë më tepër Dibrën dhe dibranët me Tiranën dhe tiranaset.

Një shembull konkret të lidhjes së ngushtë të dibranëve me tiranaset edhe në ditët e sotme e dha nën/krye-

etari i Këshillit Bashkiak të Tiranës, z. Zamir Ndroqi, i cili është nga Tiranë, ndërsa bashkëshorten e ka dibrane. Ai theksoi harmoninë dhe dashurinë reciproke që gëzojnë këto dy komunitete për njëri-tjetrin.

DOSIER

Konferenca e Londrës përfaqëson pjesën më të dhimbshme të saj për shqiptarët

Viti 1913, si u sakrifikua Gjakova dhe Dibra për të shpëtuar Shkodrën

Nga Gazmend SHPUZA

Tema e këtij shkrimi përshin një moment fare të shkurtër të historisë diplomatike të Shqipërisë, me rëndësi vendimtare për fatet e saj. Fjala është për çështjen e kufijve të shtetit të porsanjohur, me të cilën Konferenca e Londrës u mor shumë gjatë.

Dhe kjo përfaqëson pjesën më të dhimbshme të saj për shqiptarët. Porse po në këtë konferencë fuqitë europiane njohën, falë Shën Adriatikut, dhe pavarësinë e Shqipërisë, çka nuk mund të injorohet kurrsesi. Pas përgjysmimit të trupit të Shqipërisë me vendimet e padrejta të marsit dhe të gushtit të vitit 1913 nuk do të hedhim poshtë dhe vendimin e 29 korrikut të po atij viti. E shohim të nevojshme ta theksojmë këtë fakt sepse gjatë këtyre muajve në mjaft artikuj të shtypit dhe në ndonjë vepër të shkencore vendimi shumë i rëndësishëm, madje jetik për të ardhmen e shtetit shqiptar, ngatërrohet keqas me vendimet e mëparshme dhe të mëvonshme të fuqive të mëdha për copëtimin e trojeve shqiptare. E pasaktë është gjithashtu të pretendohet se vendimet për copëtimin e trojeve shqiptare qenkan sanksionuar në një traktat të Londrës të vitit 1913. Keqkuptimi arrin deri atje sa një parti politike ka afishuar mbi një urë të Lanës thirrjen patetike: "Viti 2013 fund! Traktati i Londrës"! Me sa duket, ngatërrohen vendimet e Konferencës së Ambasadorëve me Traktatin e Fshehtë të Londrës të vitit 1915, i cili parashikonte copëtimin e plotë të shtetit shqiptar. Këtë traktat populli shqiptar, duke përfutur nga koniunktura e re ndërkombëtare pas Luftës së Parë Botërore, e hodhi poshtë me Luftën e Vlorës dhe me vendimet e Kongresit të Lushnjës.

Dibra - qendra e kuvendeve dhe kongreseve historike të Rilindjes

Dibra ndodhej në mesin e trojeve shqiptare të përfshira në vilajetet perëndimore të Perandorisë Osmane. Megjithatë rrjeti rrugor i kohës nuk ia mundësonte, ajo u shndërrua, në saje të bijve të saj më të shquar, në qendrën më të parë e më të rëndësishme të Lidhjes Shqiptare të themeluar më 15 qershor 1878 në Kuvendin e Prizrenit, të kryesuar nga biri i saj Iliaz pashë Qoku. Ky bir i madh i Dibrës dhe i mbarë Shqipërisë përkrah pati Pashko Vasë Shkodranin. Atë e zgjedhën kryetar të Lidhjes, detyrë të cilën ai e kreu me qartësi politike dhe me vendosmëri deri në fund,

duke mbledhur rreth vetes atdhetarët më të vendosur nga të gjitha trojet shqiptare. Në ballë të forcave radikale të Lidhjes, duke përbulluar elementët e lëkundur dhe neutralizuar të moderuarit, duke pasur përkrah tashmë jo vetëm Ali pashë Gucinë, por dhe kryetarin e Lidhjes Shqiptare për Toskërinë, Abdyl bej Frashërin, Iliaz pasha organizoi Kuvendin e Dibrës më 14 tetor 1878. Nën kryesinë e tij ky kuvend i Lidhjes së Prizrenit siguroi bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare rreth programit të saj kombëtar të 15 qershorit 1878. Me autoritetin dhe prestigjin që gëzonte vijoi të punonte energjikisht, pa marrë parasysh moshën, për mobilizimin e mbarë shqiptarëve në luftën për

vënien në jetë të programit autonomist të Lidhjes. Nga Kuvendi i Dytë i Dibrës, që u mbledh më 10 nëntor 1880, të organizuar dhe të kryesuar po prej tij, iu parashtrua sulltanit edhe në emër të Lidhjes Shqiptare të Toskërisë të përfaqësuar nga Abdyl Frashëri dhe një herë kërkesa për krijimin e vilajetit të Shqipërisë. Meqë Stambolli bëri sërish veshin e shurdhër, udhëheqësit e vendosur të Lidhjes, të udhëhequr nga Omer Prizreni, u vunë në ballë të luftës për vënien në jetë, tashmë pa hirin e sulltanit, të vendimit të Kuvendit të Dytë të Dibrës. Ata formuan qeverinë e Lidhjes, e cila nisi të zgjerojë dhe thellojë kompetencat qeverisëse që i kishte njohur vetes që me formimin e saj. Pas Kuvendit të Dibrës ajo e shtriu pushtetin e saj nga vilajeti i Kosovës dhe sanxhaku i Dibrës në shumicën e trojeve shqiptare. Siç mund të konkludohet, në Dibrë në vitet 1878-1881 u zhvilluan takime dhe bisedime në shkallë kombëtare dhe u morën vendime themelore nga udhëheqësit më të vendosur të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në këto vite udhëheqësit më të përparuar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare me Vaso Pashë Shkodranin, ideolog i saj, Iliaz pashë Dibrën, Ali pashë Gucinë, Abdyl bej Frashërin. Omer efendi Prizrenin, kryeministri i parë i mbarë shqiptarëve, e të tjerë, hodhën themel e pavarësisë shqiptare. Pas revolucionit xhonturk dhe rivendosjes së kushtetutës Lëvizja Kombëtare Shqiptare njohu një zhvillim të vrullshëm në fushën kulturore. Të trembur përballë zhvillimeve të tilla, pas



konsolidimit të pushtetit të saposh-tënë në dorë, qeveritarët xhonturk ndërmorën menjëherë masa drastike kundër shqiptarëve. Më 23 korrik 1909 ata organizuan pikërisht në Dibrë kongresin, ku morën pjesë përfaqësues të zgjedhur nga bashkitë dhe komitetet e tyre lokale. Meqë nuk ishin të sigurt që delegatët shqiptarë, edhe pse të zgjedhur nën kontrollin e tyre, do të pajtoheshin me programin e tyre, organizatorët ftuan në kongres dhe përfaqësues të vilajetit të Selanikut. Synimi i tyre për t'i paraqitur shqiptarët mbështetës pa kushte të regjimit të tyre dështoi. Në rezolutën e kongresit u parashtruan kërkesa për realizimin e të drejtave autonomiste të shqiptarëve dhe për mësimin e gjuhës shqipe në shkollat ekzistuese në përputhje me vendimin e Kongresit të Manastirit dhe në shkollat e reja që kërkohej të ngriheshin. Shpërthimi i kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912 në Kosovë u mbështet së pari nga Dibra dhe nga lëvizja e oficerëve opozitarë të komanduar nga Tajar Tetova. Si qendër e rëndësishme e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Dibra u vu në shënjestër të terrorit xhonturk gjatë ekspeditës ndëshkimore të komanduar nga Shefqet Turgut pasha më 1910, ekspeditë që u shtri në Kosovë, në Shkodër, në Tiranë e në Manastir.

Me gjithë kontributin e dhënë nga dibranët në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare kundërosmane, ata, sikurse gjysma e popullsisë shqiptare, nuk e gëzuan pavarësinë e shpallur më 28 nëntor 1912 dhe të njohur ndërkombëtarisht disa muaj

më vonë. Në Konferencën e Londrës, në fillim të muajit shkurt 1913, diplomacia ruse në vend të Shkodrës këmbëngulte që Serbisë veç tokave të tjera t'i dhuroheshin dhe Gjakova dhe Dibra, tërësisht shqiptare. Parimi etnik nuk merrej parasysh dhe pretendimet sllave mbështeteshin, siç shënonte Theodor Ipen, mbi traditën fetare. Gjakova dhe Dibra kërkoheshin nga Petërburgu për Serbinë meqë karakteri sllav i tyre nuk mund të provohej me arsye kishtarë. Manastiri serb i Deçanit kishte prona të gjera tokësore në krahinën e Gjakovës. Ndërsa Dibra ishte selia e dy peshkopëve ortodoksë dhe fare pranë saj ndodhej manastiri ortodoks i Shën Jovan Bigorit.

Pleksja e fatit të Dibrës me atë të Shkodrës

Fati i Dibrës dhe ai i Gjakovës u lidhën ngushtë nga diplomacia ruso-franceze, e mbështetur nga ajo angleze, me atë të Shkodrës. Pretendimet serbo-ruse mbi Dibrën dhe Gjakovën u bënë edhe më këmbëngulëse pas dorëzimit të qytetit verior në duart e ushtrisë malazeze. Esat pasha e dorëzoi qytetin verior pikërisht pasi Konferenca e Londrës kishte vendosur që Shkodra t'i mbetej Shqipërisë, atëherë kur Beograd i urdhëroi tërheqjen e forcave serbe nga rrethimi i qytetit. Fuqitë e mëdha kërkuan në mënyrë ultimative nga Mali i Zi tërheqjen e forcave nga rrethimi i Shkodrës. Mbrojtësit e Shkodrës që nga maja e malit të Taraboshit kishin parë dritat e flotiljes ndërkombëtare, që kishte ardhur në brigjet e Malit të Zi dhe të sanxhaku të Shkodrës për ta detyruar krahun Nikollën që t'i nënshtrohej vendimit të fuqive të mëdha. Të gjitha këto rrethana nuk e përligjin kurrsesi qëndrimin kapitjes të pashait.

Përballë qëndrimit këmbëngulës proserb të Rusisë dhe të Francës Shkodra u shpëtua nga diplomacia austriake, duke sakrifikuar Gjakovën dhe Dibrën. Pra, akti tradhtar i pashait toptanas qe fatal për fatin e Dibrës dhe të Gjakovës. Pretendimet e Serbisë për Gjakovën dhe Dibrën në shkëmbim të një qyteti të madh siç ishte Shkodra për ambasadorin e Francës në Londër P. Cambon na ishin një "kërkesë e arsyeshme". Dhe sipas ambasadorit anglez Kartrajt pazarlleqet e Londrës në kurriz të trojeve shqiptare

bëheshin "në emër të paqimit në marrëdhëniet midis fuqive të mëdha".

Ndërkohë 1000 e ca dibranë vijonin të luftonin në mbrojtjen e Shkodrës. Porse këto sakrifica të mbrojtësve dhe të qytetarëve të Shkodrës të mbështetur nga dibranët u tradhtuan nga Esat pasha. Vrasja e Hasan Riza pashës dhe dorëzimi i Shkodrës u bënë viktima të ambicieve të pashait toptanas, siç kujton atdhetari i shquar dibran Ismail Strazimiri, partizani 73-vjeçar, dëshmor i LANÇL.

Shkodra me rezervat ushqimore dhe luftarake të siguruara ishte në gjendje t'u rezistonte sulmeve të pareshtura të malaziasve edhe katër-pesë ditë të tjera. Këto ditë ishin të mjaftueshme deri në zbatimin e vendimit të fuqive të mëdha për heqjen e rrethimit nga ana e krahut Nikollës, që ndodhej nën presionin e demonstratës së tyre detare. Esat pasha duke ia shitur Shkodrën Malit të Zi në të vërtetë shiti Gjakovën dhe Dibrën. Me demagogjinë tij dhelparake dhe të paskrupull në kurriz të dibranëve, që morën pjesë në mbrojtjen e Shkodrës, Esat pasha u përpoq të bindte dibranët se do "ta çlironte Dibrën e pushtueme prej serbëve"! Marrëveshjet e tij me Pashiqin një vit më vonë flasin për pazarllëqe të reja në kurriz të trojeve të mbetura brenda shtetit shqiptar. Demagogjia e Esat pashës Toptanit arriti kulmin gjatë kryengritjes së shtatorit 1913, e cila nisi në Dibrë, duke premtuar ndihma në armë e municione. Në të njëjtën kohë ai ushtronte presion mbi Ismail Qemalin që qeveria e Vlorës të angazhohej direkt në ndihmë të kryengritësve. Me këtë aventurë synonte t'u jepte pretekstin ushtrive serbe për të marshuar brenda tokave të shtetit shqiptar. Forcat që mbledhi në Tiranë ndërkohë që kishte përhapur fjalë se do t'i niste në ndihmë të dibranëve, ai i drejtoi kah Lushnja kundër qeverisë së Vlorës.

Më sipër u përpoqem të provojmë se Dibra e kuvendeve dhe e kongreseve historike të Rilindjes, sikurse afro gjysma e trojeve shqiptare, nuk e meritonte fatin historik që i caktuan përfaqësuesit e tyre të Londrës më 1913 pa dëgjuar të paktën zërin e përfaqësuesve legjitimë të popullit shqiptar. Nga ana tjetër, dibranët dhe mbarë populli shqiptar nuk ua pati borxh të gjithë atyre që u vunë në shërbim të armiqve të kombit tonë në të gjithë atë vorbull të pazarllëqeve diplomatike të fuqive të mëdha dhe të monarkive të Ballkanit.

SPECIALE

Gjermani / fitorja e Merkel, për vazhdimësinë, por në tjetër kontekst

Kancelarja mund të qën drojë në post. Por qeveria e udhëhequr nga ajo do të ndryshojë. Detyra për krijimin e qeverisë i mbetet Angela Merkelit, Unioni i saj CDU/CSU fitoi 42 për qind të votave dhe është partia më e fortë në Parlamentin gjerman.

Por CDU e ka humbur partnerin e saj liberal. Gjermania me sa duket do të qeveriset në katër vitet e ardhshme - ose nga një koalicion mes kristiandemokratëve dhe socialdemokratëve, ose vetëm nga kristiandemokratët.

Bonusi si kancelare i Angela Merkelit ishte i paarrtshëm - dhe partia e saj, CDU, përfitoi nga reputacioni i kandidates kryesore. CDU-ja arriti fitoren më të madhe në zgjedhje që prej dy dekadash! Rezultati zgjedhor solli edhe një rënie historike të partnerit të vogël në qeveri: FDP-ja, e cila katër vjet më parë hyri në qeveri me rezultatin e saj më të lartë zgjedhor prej 14 për qind, nuk arrin të hyjë në Bundestag. Një humbje absolute për partinë dhe një pikë e vërtetë kthese në peisazhin politik në Gjermani, për shkak se liberalët kanë qenë të përfaqësuar që nga themelimi i Republikës Federale Gjermane në vitin 1949 në Bundestag.

Me sa duket sukseset e qeverisë së koalicionit janë parë si sukses i Kancelares: Gjermania ka normën më të ulët të papunësisë në Evropë, një rritje solide ekonomike, nivel të ulët borxhi. Dhe të gjitha këto pa shtërngesa të vërteta për shumicën e gjermanëve. Kjo i ka bindur votuesit. Ata donin vazhdimësinë, stabilitetin dhe sigurinë - dhe këto i lidhin me Angela Merkelin. Pas tetë vjetësh në post ajo është vërtet një politikane me pushtet. Ajo i ka bllokuar në mënyrë konsekuente temat qendrore të opozitës: më tepër drejtësi sociale, lehtësi për familjet, heqja e shërbimit ushtarak të detyrueshëm, mosndërrhyrje në Libi apo Siri, iniciimi i transformimit në fushën e energjisë. Qeveria e koalicionit e katër viteve të kaluara ishte vërtet një koalicion konservator në letër, por në shumë çështje ajo ndoqi një politikë socialdemokrate e nganjëherë madje edhe të gjelbër. Pragmatizëm i pastër: ky është parimi Merkel, dhe ky pëlqehet nga populli!

Për Merkelin - dhe padyshim edhe për mbështetësit e saj - vazhdimi i veprimtarisë politike në një koalicion të madh nuk do të jetë problem. Përkundrazi së bashku me socialdemokratët me siguri do të jetë më e lehtë për të përballuar rezistencën në Këshillin e Federatës që dominohet prej SPD-së dhe Të Gjelbërve. Aktualisht ky institucion ku përfaqësohen landet gjermane, bllokoi ligje të rëndësishme.

Erozion

Peizazhi politik i Gjermanisë po ndryshon. Koordinatat janë zhvendosur. SPD dhe Të Gjelbërit nuk mund të jenë të kënaqur me rezultatin e tyre. Megjithë shtimin e dukshëm të simpatisë për kandidatin kryesor të SPD-së Peer Steinbrück në javët e fundit të fushatës zgjedhore, partia arriti të fitonte vetëm tre për qind më tepër vota, gjithësej 26 për qind. Kjo shifër është më e ulët nga sa shpresonte SPD-ja. Partia Socialdemokrate është duke luftuar për statusin e saj si një parti popullore. Kjo lidhet pjesërisht me faktin se temat socialdemokrate u përvetësuan nga politika e Kancelares. Dhe nga ana tjetër se SPD-ja vetë nuk mundi të tregojë bindëse. Një çerek shekulli pas ribashkimit të Gjermanisë partia E Majta - partia pasardhëse e ish-Partisë së Bashkuar Socialiste të Gjermanisë (SED) të RDGJ-së - është bërë partia e tretë më e madhe në vend. Partitë e vogla, para së gjithash "Alternativa për Gjermaninë", tregoi profil të qartë. Kjo parti, e cila është skeptike ndaj euros mori votat e votuesve protestues, atyre të paorientuar dhe të të zhgënjyerve nga të gjitha kampet politike.

Balanca e pushtetit ka ndryshuar tërësisht. Por pse ndodh kështu? Shumë parti, sidomos Të Gjelbërit dhe Liberalët ishin të preokupuar kryesisht me veten. Për diskutime vanitoze dhe anti-tema si rritja e taksave - votuesit nuk kanë mirëkuptim. Lufta elektorale u zhvillua pa pasione të mëdha dhe polemika. Një efekt i kësaj politike të butë, me pak dallime ishte se një e treta e votuesve nuk e dinte as pak para zgjedhjeve, se për cilën parti do të votonte. Kancelarja dhe opozita e prezantuan politikën e tyre si shërbim ndaj votuesve. Në vend të debateve politike pati reklama për produktin politik. Kjo nuk është një prirje që prek vetëm Gjermaninë: megjithatë politika sot është edhe më pak politike se sa në të kaluarën. Gjermania në vitin 2013 ka zënë vend në zonën e rehatit!

Si "Zgjedhje që vendosin për Evropën", u konsideruan zgjedhjet në vendet në krizë dhe vendet fqinje të Gjermanisë. Shumë nga fqinjët tanë presin një kurs më të moderuar, më pak të ashpër në menaxhimin e krizës financiare, në rast se Gjermania do të qeveriset nga një koalicion i madh. Por këto ishin edhe zgjedhje që vendosin për çështje të rëndësishme për të ardhmen në Gjermani. Si do të sigurohen pensionet në Gjermani me popullsinë në plakje? Si do të financohet kthesa në fushën e energjisë? Ç'qëndrim do të mbajë Gjermania ndaj krizës Siri? Dhe cili është - përtej menaxhimit të pastër të krizave - vizioni ynë i vërtetë politik për një Evropë të zgjeruar? Këtu prej



Gjermanisë kërkohet politikisht shumë më tepër se sa duan të besojnë udhëheqësit politikë. Gjermania - ekonomia më e madhe e Evropës dhe e katërta më e madhe në botë - kërkon komoditetin dhe merret me veten. Gjithësesi me shumë sukses.

Detyra e politikës është të tërheqë vëmendjen e votuesve dhe të jo-votuesve për këto çështje dhe t'i ftojë për të diskutuar dhe menduar. Demokracia është gjithmonë negocium kompromisesh të reja. Këto sikurse dihet nisen nga pozicione të ndryshme dhe janë rezultat i një debati. Politika duhet të bëhet përsëri politike, kështu mendoj unë. Jo vetëm administrimi politik i Gjermanisë, por formësimi - kjo është detyra për qeverinë e re, për përbërjen e së cilës do të negociohet ditët e ardhshme.

MARRREDHENIET PAS ZGJEDHJEVE

Po tani, me Evropën? Por pavarësisht se çfarë qeverie do të formohet, Parisi pret që marrëdhëniet francozo-gjermane të bëhen më të thjeshta. Mediet dhe opinioni publik në Francë e kanë ndjekur me shumë vëmendje fushatën elektorale. Angela Merkel vlerësohet si kryetare qeverie pasi ajo mishëron suksesin gjerman. Nëse do të kishin votuar francezët ata do ta kishin zgjedhur me shumicë Merkelin. Por mundësia e një koalicioni të madh i habit francezët.

Edhe në vende të tjera evropiane, zgjedhjet për Parlamentin federal në Gjermani janë ndjekur me vëmendje. Kush qeveris në Berlin, përcak-

ton në masë të madhe politikën e Evropës.

Nicolas Barotte, korrespondent në Berlin i gazetës konservatore franceze "Figaro", shkruan: "Presidenti socialist i Francës François Hollande kishte pak shpresa për një fitore të socialdemokratëve gjermanë (SPD). Për të zgjidhja më e mirë do të ishte tani një koalicion i madh. Franca shpreson në më shumë konsum në Gjermani dhe një zbutje të pozicionit gjerman, sa i takon politikës së rritjes ekonomike në Evropë. Por pavarësisht se çfarë qeverie do të formohet, Parisi pret që marrëdhëniet francozo-gjermane të bëhen më të thjeshta. Mediet dhe opinioni publik në Francë e kanë ndjekur me shumë vëmendje fushatën elektorale. Angela Merkel vlerësohet si kryetare qeverie pasi ajo mishëron suksesin gjerman. Nëse do të kishin votuar francezët ata do ta kishin zgjedhur me shumicë Merkelin. Por mundësia e një koalicioni të madh i habit francezët. Në Francë dallimet mes kampit të majtë dhe atij të djathtë janë shumë më të mëdha. Një koalicion i madh do të ishte i pamundur në Francë".

Gazetari i lirë Janis Papadimitriu ka mbledhur në Athinë zërat nga Greqia: "Një skenar i mirë për Greqinë do të ishte një koalicion i madh, është i mendimit kanali kryesor televiziv grek Mega Channel. Këtë e kishin konfirmuar për televizionin edhe përfaqësues të Ministrisë së Financave në Athinë. Kokëçarje u shkakton gazetarëve grekë ngritja e papritur e fortë e euroskeptikëve të partisë "Alternativa për Gjermaninë". Mega Channel e cilëson atë si

parti të ekstremit të djathtë. Tasos Teloglou nga kanali STAR e sheh gjithashtu pozitive për Greqinë mundësinë një koalicioni të madh, pasi socialdemokratët tradicionalisht 'angazhohen për forcimin e kërkesës së brendshme në BE', nga e cila do të përfitonin vendet me borxhe në jug të Evropës. Korrespondenti në Bruksel i kanalit televiziv, Thanos Athanasias, është i mendimit se tani është hapur rruga për një rikapitalizim të bankave greke nga mekanizmi i BE-së për shpëtimin e euros

Asnjëherë më parë nuk janë ndjekur zgjedhjet në Gjermani me aq vëmendje sa këtë herë. 'Gjermanët votojnë, Evropa është në pritje', titullonte të dielën e zgjedhjeve një nga gazetaret kryesore greke Kathimerini. Në disa raste shprehet frika se qeveria e re Gjermane mund t'a linte në baltë Greqinë. Ish presidenti i Parlamentit Evropian Hans-Gert Pötering, përpjetë megjithatë të qetësojë: Berlini do të vazhdojë të mbështesë Greqinë, siguron politikani në një intervistë me Kathimerinin.

Flaminia Bussotti nga agjencia italiane e lajmeve ANSA, mendon: "Zgjedhjet parlamentare në Gjermani u ndoqën me vëmendje edhe në Itali të madhe, ashtu si në gjithë Evropën: mediet, politikanët, por edhe njerëzit e thjeshtë donin të dinin se nga kush dhe si do të qeveriset Gjermania. Ata e dinë se shumë nga ajo çka ndodh në Itali, nuk vendoset në Romë ose jo vetëm në Romë, por edhe në Bruksel dhe Berlin. Edhe pse ndoshta jo me të njëjtën



forcë si në Greqi, në Itali është i përhapur opinioni se Gjermania është përgjegjëse për programet e rrepta të kursimit, për paralizimin e ekonomisë që ka si pasojë rritjen e papunësisë. Muajt e fundit ka pasur disa shprehje pakënaqësie në popull, të shoqëruara nga fenomene populiste, të cilat ndërkohë falë Zotit janë qetësuar.

Në Itali nuk mbizotërojnë ndjenja antigjermane, por zërat kritikë dëgjohen mirë. Nga konstelacionet e mundshme për qeverinë e ardhshme gjermane, Italia konsideron një koalicion të madh si alternativën më të mirë për Evropën dhe Italinë. Theksi do të vihej atëherë më shumë tek rritja se sa tek konsolidimi i buxhetit dhe kjo do të thoshte më shumë frymëmarrje për ekonominë. Përpjekjet për reforma dhe kursime, do të vazhdonin megjithatë, thonë të gjithë politikanët drejtues. Nëse u beson opinionistëve këtu, qeveria e ardhshme Merkel do të përqendrohet patjetër më shumë se deri tani tek rritja. Kjo pritet me tension në Itali".

Frank Vermeulen nga gazeta holandeze "NRC Handelsblad", ka vuarë mendjen për konstelacionet e mundshme politike në Gjermani: "Një koalicion i madh do t'i bënte këto zgjedhje më të mërzitshmet që prej fundit të Luftës së Dytë Botërore. Nga ana tjetër duket se ka disa lëvizje të zgjedhësve në skajet e politikës. Nëse liberalët (FDP) zëvendësohen nga konservatorët skeptikë ndaj euros (AfD), ky do të ishte një zhvillim pozitiv, pasi kështu në Parlament do të përfaqësohej qytetari i zemëruar. Disavantazhi do të ishte një periudhë më e paqëndrueshme në demokracinë gjermane. Por nëse Merkel do të arrinte shumicën absolute, vendi më i rëndësishëm në qendër të Evropës do të qeverisej nga një lëvizje e vetme politike. Kjo do t'i bënte të mendoheshin Gjermaninë dhe pjesën tjetër të Evropës".

SOCIALDEMOKRATET

Zhgënjim i të humburve

Ashtu si pritej, rezultatet e votimit nuk mjaftojnë për një koalicion qeverisës të socialdemokratëve me ekologjistët. Por partia mund të ketë tani si objektiv pjesëmarrjen në një koalicion të madh.

Pritej, ose të paktën shpresohet për më shumë. Kandidati socialdemokrat për kancelar Peer Steinbrück kandidoi për të zëvendësuar Angela Merkelin dhe të krijonte qeverinë së bashku me ekologjistët (Bündnis 90/Die Grünen). Por nga ky objektiv socialdemokratët janë shumë larg. Partia arriti të shënojë vetëm një rritje të lehtë të numrit të votave prej 3 për qind. Në zhgënjimin për rezultatit e vet, përzihet megjithatë kënaqësia për humbjen e liberalëve (FDP) të cilët nuk arritën prapë prej 5 për qind për të hyrë në Parlament. Kështu koalicioni konservatoro-liberal nuk u rizgjodh. Në qendrën e socialdemokratëve, pallatin Eilly-Brandt, shpërthyen brohoritje frenetike kur u bë e ditur humbja e FDP-së. Kandidati socialdemokrat për kancelar Steinbrück dhe kryetari i SPD-së, Gabriel. Kandidati socialdemokrat për kancelar Steinbrück dhe kryetari i SPD-së, Gabriel. Tani socialdemokratët do të konsultohen nëse do të hyjnë në një koalicion të madh me kristiandemokratët. Atmosfera në SPD ish-



Reuters

te qysh para ditës së zgjedhjeve pozitive ndaj kësaj pyetjeje: socialdemokratët nuk do ta refuzojnë mandatin e dhënë nga zgjedhësit dhe do të formojnë përsëri një qeveri me Unionin Kristiandemokrat/Kristiansocial.

Por kandidati socialdemokrat për kancelar Peer Steinbrück, nuk është i gatshëm të marrë post ministri në një koalicion të tillë. "Unë dua të jem kancelar në krye të një koalicioni mes socialdemokratëve dhe ekologjistëve", tha ai për "Bild am Sonntag". "Për kabinetin e një koalicioni të madh nuk do të isha në dispozicion." Në të njëjtën kohë ai nënvizoi se edhe në rast humbjeje do të vazhdojë të luajë një rol drejtues në SPD. Se cili do të jetë ky rol do të varej nga rezultati i zgjedhjeve. Ndoshta ai do të drejtojë negociatat me Merkelin për krijimin e qeverisë. Në koalicionin e madh që qeverisi në Gjermani nga 2005 deri 2009 Steinbrück ishte ministër i Financave. Raporti i tij me Kancelaren Angela Merkel konsiderohej në atë kohë si plot besim dhe konstruktiv. Së bashku atyre iu desh të përballonin fillimin e krizës financiare. E paharruar është dita kur në një paraqitje dramatike në televizion, ata u prematuan gjermanëve se kursimet e tyre do të ishin të sigurta.

Kandidati i SPD-së për kancelar luftoi deri në fund. Ai nuk u dekurajua nga rezultatet e pavaforshme të sondazheve për partinë e tij. Në ditët e fundit para zgjedhjeve ai dukej mjaft komfortabël në rolin e sfiduesit të Merkelit. Me shumë shpirt luftarak dhe energji kreu një program elektoral të ngjeshur me fjalime publike dhe paraqitje të shumta në televizion. Në duelin televiziv me Kancelaren Merkel mori jehonë pozitive nga shikuesit. Në finish të garës, dukej se ishin harruar thujtje plotësisht disa nga gafat e fillimit të kandidaturës. Duke hedhur votën të dielën në një qendër votimi në Bonn, ku jeton me bashkëshorten, Steinbrück tha se fushata i kishte falur shumë kënaqësi. SPD që në gjendje të profilizohej qartë kohët e fundit, tha Steinbrück.

GJERMANI / ZGJEDHJET

Rënia e dhimbshme e liberalëve Një rënie kaq e thellë, kaq e

dhimbshme. Është "ora më e hidhur për FDP", tha Christian Lindner i liberalëve gjermanë (FDP), pasi u publikuan rezultatet e para. Rezultati zyrtar: 4,8 për qind. Një humbje prej rreth 10 për qind. Për herë të parë që prej vitit 1949, partia e tij nuk merr asnjë vend në Bundestag. Lindner, kryetar i FDP-së në landin Nordrhein-Ëestfalen, zakonisht një orator elokuent dhe që rrezaton vetëbesim, e përballoi me vështirësi dhe shprehje të ngurta intervistën e parë në televizion të dielën në mbrëmje (22.09.). Kjo është fytyra e zhgënjimit.

Para së gjithash sepse në zgjedh-



jet e kaluara parlamentare 2009, FDP kishte shënuar rezultatit e saj më të mirë: 14,6 për qind. Po tani? Një rënie e pashembullt, nga rezultat rekord në humbje rekord. "Ishte fatuara për politikën e bërë prej FDP-së", thotë politologu Ulrich von Alemann. "Liberalët kanë bërë gabime në politikën, programin dhe fushatën e tyre elektorale, por edhe në zgjedhjen e personave drejtues".

Katër vjet zgjat një legjislaturë në Gjermani, për FDP-në këto ishin katër vite ngjitur dhe rënieje. Rënia filloi direkt para zgjedhjeve: nën tryshinë e liberalëve dhe kristiansocialëve (CSU), qeveria vendosi të ulë TVSH-në për fjetjet në hotel. Thujtje në të njëjtën kohë u bë publik një donacion milionësh i një sipërmarrje hotelesh për FDP-në. "FDP u perceptua menjëherë si parti klienteliste, si parti interesash, që synon t'ua bëjë jetën më të lehtë taksapaguesve të mëdhenj", thotë Alemann. Kësaj iu

shtuan edhe zënkat në gjirin e partisë: Guido Eesterëelle-s, iu desh të jepte dorëheqjen në 2011 nga postet e zv/kancelarit dhe kryetarit të partisë, ndër të tjera për shkak të vlerave në rënie të popullaritetit. Por edhe nën drejtimin e kryetarit të ri të partisë Philipp Rösler, tendenca e rënies vazhdoi. Pikën më të ulët partia e arriti në 2012 në zgjedhjet për parlamentin e landit të Zaris: 1,2 për qind, rezultati më i dobët i liberalëve në një land perëndimor që prej themelimit të partisë.

Rezultate të mira pati para së gjithash kur kandidatët në nivel landi u distancuan nga partia në rang

vetëm 44 vjet qeverisje. Nga 1969 deri 1998 liberalët kanë qeverisur pa ndërprerje me partnerë të ndryshëm: fillimisht me socialdemokratët (SPD) dhe pastaj me Unionin (CDU/CSU). Asnjë parti nuk ka qenë më gjatë pa ndërprerje në pushtet. Por FDP ishte vazhdimisht partneri i vogël.

Dhe kjo u bë pjesë e problemit: "Forca e Merkelit u kthye në dënimin e FDP-së. Për përmasat e humbjes kanë përgjegjësi në radhë të parë Kancelarja dhe Unioni", thotë von Alemann. Suksesi elektoral në 2009 u bazua para së gjithash tek zgjedhësit që ndryshojnë. Ata ishin të zhgënjyer nga ish-koalicioni i madh mes konservatorëve dhe socialdemokratëve, veçanërisht nga CDU. Tani ata kanë gjetur tjetër destinacion. Por që FDP nuk kaloi pragun për të hyrë në Bundestag, sipas mendimit të politologut, u kushtëzua nga dikush tjetër: "Pa partinë 'Alternativa për Gjermaninë' (AfD), FDP do të kishte hyrë me siguri në Parlament".

Sinjale për daljen e mundshme të FDP-së u dhanë që në sondazhet para zgjedhjeve: herë 4 për qind, herë 6 për qind, gjithnjë rezultat i ngushtë. Dhe pastaj një javë para zgjedhjeve për Bundestagun, qytetarët në Bavari nuk i dhanë FDP-së votat e mjaftueshme për të hyrë në parlamentin e landit. Aktualisht FDP është e përfaqësuar në vetëm tetë nga 16 parlamentet e landeve dhe vetëm në një land merr pjesë në qeveri. Koha për të dhënë lamtumirën? Jo, thotë politologu Ulrich von Alemann: "FDP është këmbëngulëse. FDP ka një histori të madhe. Ajo ka mbajtur mandatesh kudo, edhe në komuna. Ajo ka rrënjë solide në shoqëri, në opinion dhe për këtë arsye ky nuk është fundi i FDP-së". Por krahet e ndryshëm të partisë duhet të lidhen përsëri qartë dhe besueshëm me njëri-tjetrin. Njeriu i duhur për këtë është ndoshta Christian Lindner, ish sekretari i përgjithshëm. Humbja është kaq e thellë, tha ai të dielën në mbrëmje: "Nga nesër FDP duhet të rikoncepohet".

Rindërtimi do të jetë i mundimshëm, por për këtë liberalët do të kenë katër vjet kohë, deri në zgjedhjet e ardhshme për Bundestagun.

REAGIMI

NDËRKOMBËTARË, HIQNI, NDRYSHONI REZOLUTËN 1244

Evrova, bashkësia ndërkombëtare do dhe kërkon paqe, liri, drejtësi, stabilitet. E derisa të ekzistojë shantazhi i dikujt që mban tokën e huaj në bazë të dofarë letrave të nënshkruara për ta zgjidhur një konflikt, sado i përgjakshëm që të këtë qenë, stabilitet nuk do të këtë.

As atëherë as tash nuk kemi in-sistuar që Kosova të bashkohet me Shqipërinë edhe pse shumë prej nesh kemi qenë gati të japim edhe jetën për këtë bashkim. Por as me Turqinë apo me ndonjë shtet tjetër islamik apo të ndonjë konfesionit a formacionit tjetër ideologjik, politik apo tjetër. Aq me pak me Serbinë, e cila luftën e vet çlirimtare e ka shndërruar në zaptuese. Edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, edhe gjatë luftës çlirimtare të popullit tonë pas saj kemi luftuar dhe kërkuar të vendosim vetë në bazë të parimeve të vetëvendosjes së popujve si subjekte të kompaktësisë së shumicës etnike me të drejta të barabarta të të gjitha etnive aq më parë që një kohë të gjatë vetë kemi qenë të robëruar e të shtypur...


Atëherë e sot Serbia me 1244-shin po na mban në lak të litarit Por nuk kemi dashur as nuk duam të bashkohemi as me dikë tjetër. Si-domos jo të na imponohet ndonjë "bashkim", pra as me Serbinë, me të cilën tash e një qind vjet më parë na ka lidhur Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe atëherë e sot Serbia me të po na mban në lak të

e ushtrie e kamufluar në dofarë "rojash të urës", "mbrojtjesh nacionale" por edhe xhandarësh me uniforma zyrtare, ende po qarkullojnë në një pjesë të Kosovës e herë-herë edhe po hyjnë e kërcënojnë qytetarët tanë të qetë në fushë, në rrugë, në punë, në jetë, në shtëpi të vet.

E kështu ishte, kështu është dhe kështu do të jetë derisa të mos ndryshohet kjo Rezolutë që e hoqi njëherë e përgjithmonë Serbinë prej këtu. Por jo! Ajo nuk është hequr. Se Rezoluta 1244 e vitit 1999 edhe atëherë edhe tash mund të mbështetet në vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londrën e vitit 1913. Ajo duhet të hiqet apo të reduktohet. Se kufijtë e pranuar ndërkombëtarisht vërtet mund të ndryshojnë me luftë, por do të mbeten të ndryshuar vetëm në letër derisa të njihen ndërkombëtarisht.

Ne kemi pasur fatin e keq që gjithmonë të kemi telashe me të ardhurit në tokën tonë. Shumë prej të ardhurve kanë ardhur e kanë shkuar. Një numër i sllavëve të jugut kanë ardhur dhe kanë mbetur. Kanë lënë edhe gjurmë. Me kohë janë ambientuar dhe jemi ambientuar. Luftërat nëpër të cilat kemi kaluar, pos viktimizeve e shkatërrimeve, kanë lënë pasojë për të dy palët - vendësit e të ardhurit.

Shantazhet edhe sot e rrezikojnë stabilitetin e rrjedhimisht edhe paqen Evropa, bashkësia ndërkombëtare do dhe kërkon paqe, liri, drejtësi, stabilitet. E derisa të ekzistojë shantazhi i dikujt që mban tokën



- të mbetura nga luftërat e zënkat nga të cilat hapësira jonë nuk është çliruar dhe nuk ka mbetur e çliruar as sot e kësaj dite.

Pa hyrë në histori, të themi se ne qe kemi kaluar nëpër Luftën e Dytë Botërore dhe ato që kanë pasuar pas saj dhe në këtë luftën tonë të fundit në të cilën u rrënuar gjithçka që ishte arritur të ndërtohej, me sakrificat të mëdha, gjithë ajo që ishte ndërtuar për gati dyzet vjet të paqes relative.

Edhe kjo lufta e fundit në Kosovën tonë, që mori me vete më se 15 mijë të vrarë e të masakruar, afro 2000 të humbur e më se 800 mijë të dëbuar nga trojet e veta e shumë e shumë të mbetur jashtë vendit dhe jashtë shtëpive e trojeve të veta në Kosovën e çliruar.

Ende jetojmë në pasiguri, frikë për të sotmen e të ardhmen, për ne dhe pasardhësit tanë. Sepse ka mbetur me shkrim një shpatë e Damokliut që na kërcënon, që na rrezikon, që na shqetëson, në shtëpinë tonë, në vendin tonë të punës nëse e kemi, në tokë, në shtëpi, në arë, në punishte...

Po, bashkësia ndërkombëtare: OSBE, Unioni Evropian, organizatat bamirëse ndërkombëtare, njerëz-

it e vullnetit të mirë, janë munduar dhe po mundohen ta mjekojnë këtë vend për shumë kohë të shkelur, të shtypur, të nëpërkëmbur, ta ndihmojnë të ngriten në këmbët e veta, ta mbajë veten, të mos jetë barrë e tyre dhe e askujt tjetër.

Kosova jonë i ka të gjitha resurset për të jetuar e zhvilluar

Kosova jonë i ka të gjitha resurset për të jetuar e zhvilluar. E dinë këtë edhe ata që na ndihmojnë.

Dhe na kanë ndihmuar. Na kanë ndihmuar t'i përzëmë të huajt nga trojet tona, Ta luftojmë edhe fashizmin në kohën e Luftës së Dytë Botërore, ta dëbojmë edhe falangën e fundit - ushtrinë e policinë serbe, forcat paramilitare terroriste dhe të vendosim paqen në shtëpinë tonë. Dhe sado e brishtë të jetë, ajo na siguron që të ngritemi në këmbët tona, të jetojmë me lëngun tonë, me të mirat që na ka dhuruar natyra, të mos jemi e sidomos të mos mbetemi barrë e botës bashkëkohore. Këtë mund ta bëjmë se kemi resurse të pasura natyrore, kemi popullsi të re, kemi djem e vajza të gatshme për t'u përballuar me jetën, për ta ndër-tuar atë.

Por... Por, ah, është diçka që na pengon, që na shantazhon, që nuk na lë të ngritemi në këmbë, që të ecim përpara.

Kjo diçka, është Ajo që nga fundit i luftës së fundit na shpëtoi nga

zhbërja. Kjo është Ajo që na shpëtoi dhe që na la të lidhur me një Rezolutë të saj.

Me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara e cila Kosovën e çliruar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Bombardimet e NATO-s i dëboi forcat ushtarako-policore e paramilitare serbe nga Kosova.

Por e la Kosovën ende nën sovranitetin shtetëror të Serbisë trashëgimtare të Jugosllavisë së shpërbërë.

Dhe Serbia, shteti serb, përfaqësuesit e saj na shantazhojnë dhe na kërcënojnë me të - me Rezolutën 1244, e cila nuk ka "vdekur" dhe nuk është shuar derisa të hiqet. Të ndryshohet ose të ndërrohet me një tjetër.

Tash që Republikën e Kosovës e kanë njohur më se 100 shtete të botës.-

Tash që Kosova po troket në derë të Bashkimit Evropian.

Prandaj, miq të Kosovës, këtu në Kosovë dhe jashtë saj, ndryshoni, hiqni Rezolutën 1244, që të mos na shantazhojë edhe më tutje Serbia, që të mos na kërcënojë mbi kokë si Shpata e Damokleut.

Kryesia e Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës

Vehap SHITA,
ushtrues i detyrës së Kryetarit
Prishtinë, 18 shtator 2013



litarit. E do të na mbajë derisa të mos na hiqet qafet Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Vërtet, kjo Rezolutë ndryshoi shumëçka: e dëboi ushtrinë e policinë serbe nga trojet tona. Mendonim përgjithmonë. Sepse ishte nga forumi më i lartë ndërkombëtar. Megjithatë, një pjesë e kësaj policie

e huaj në bazë të dofarë letrave të nënshkruara për ta zgjidhur një konflikt, sado i përgjakshëm që të këtë qenë, stabilitet nuk do të këtë. Fatkeqësisht, shantazhet edhe sot e rrezikojnë stabilitetin e rrjedhimisht edhe paqen.

Bashkësia ndërkombëtare nëpërmjet forumeve të veta po përpiqet t'i mjekojë plagët e hapura

PERKUJTMORE

Shoqata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës, tubim përkujtimor me rastin e 5-vjetorit të ndarjes nga jeta të udhëheqësit politik të Rrethit të Istogut

KONTRIBUTI I SAIT ZATRIQIT PËR LIRINË DHE ZHVILLIMIN E KOSOVËS

Sait Zatriqi u lind në Pejë më 15 maj 1918, shkollën fillore dhe dy klasë të shkollës ekonomike i kreu në Pejë. Për të siguruar kushte jetësore detyrohet të punojë si shëgert.

U shkollua në Shqipëri

Në moshën 14 vjeçare edhe ose djalë i hasretit, Saiti ik në Shqipëri me dëshirën e flakët që të shkollohet në gjuhën shqipe. Ky vendim i Saitit ishte shumë i rëndësishëm për familjen e tij, duke pasur parasysh edhe rreziqet e kalimit kufirit. Por, babai i Saitit, Rexhepi, me profesion hoxhë, me ndihmën e një fshatari nga Babaj i Bokës, arriti që ta siguronte kalimin ilegal të kufirit dhe Saiti nga Malësia e Gjakovës arriti në Tiranë. Aty, në vitin 1933, regjistrohet në shkollën e mesme. I rritur dhe i edukuar në një familje përparimtare arsimdashëse, si nxënës aktivizohet në organizatën e rinisë përparimtare dhe, pas një aktiviteti kundër sistemit aktual, përjashtohet nga shkolla shtetërore dhe vazhdon shkollimin në Institutin shqiptaro-amerikan - shkolla e Fullcit, të cilin e përfundon në vitin 1939. Pas kryerjes së shkollës, si i ri përparimtar, merr pjesë në demonstrata kundër okupatorit italian në disa qytete të Shqipërisë si, në Tiranë, Durrës, Kavajë e Shkodër.

Në qershor të vitit 1941 Saiti vendos të kthehet në Kosovë, siç vepruan shumë të rinj shqiptarë të shkolluar në Shqipëri, të cilët aktivitetin e tyre antifashist kundër okupatorit e vazhduan në Kosovë. Në Pejë Saiti takohet dhe bashkëpunon me shokët Ramiz Xhemën, Fadil Hoxhën, Ismet Shaqirin etj. Në shtator të vitit 1941 caktohet në detyrën e sekretarit të Komunitetit të Krahinorë në Istogut. Për Saitin kjo ishte një mundësi e mirë për të vazhduar aktivitetin e vet politik kundër okupatorit fashist. Në qershor të vitit 1942, nga detyra e sekretarit të komunitetit të Krahinorë, transferohet si sekretar në komunitetin e Istogut. Në Istogut formon celulën e partisë me djem të rinj përparimtarë, ndër ta: Ali Fetahu, Rexhë Bala, Rexhep Kabashi, Rexhë Murati, Selim Rustemi, Abdullah Haxhë-mësues nga Elbasani. Në mesin e tyre ishte edhe Xhafer Haxhijakupi, i cili tash po e udhëheq me sukses shërbimin financiar të Shoqatës sonë. Po përmend një rast nga aktivitetet e Saitit në Istogut. Në korrik të vitit 1943 gjatë faljes së Bajramit në xhaminë e Istogut, ku ishin pjesëmarrës nga rreth 7 fshatra të kësaj treve, Saiti ngjitet në shkallë të murit në hyrje të oborrit të xhamisë dhe publikisht para masës mban një fjalim kundër okupatorit fashist dhe shërbëtorëve të tij. Ai organizon gjithashtu, takime nëpër fshatra duke zhvilluar propagandë antifashiste. Në një takim me të rinjtë përparimtarë në fshatin Cerce, Saiti arrestohet nga xhandarmëria. Mirëpo, para se xhandarmëria hyn në odën ku mbahej takimi, Saiti me shokë duke e hetuar rrezikun të gjithë materialin propagandistik antifashist e gjuajnë në oxhak dhe kështu digjet pa u rënë në dorë xhandarëve. Natyrisht, aktiviteti i tij ra në sy të agjentëve të regjimit dhe së shpejti u arrestua nga kuestura fashiste italiane. Fillimisht ishte në burg në Kullën e Sheremetit në Pejë, prej nga u transferua në burgun e Tiranës dhe nxor para Gjyqit Usharak në Tiranë për veprë penale: propagandë kundër shtetit me "provë materiale" procesin e vetëm fletëparaqitjen e xhandarmërisë së Istogut. Në gjykim në Tiranë nuk ishte paraqitur asnjë dëshmitar që do të dëshmonte

për propagandën antifashiste të Saitit në oborrin e xhamisë së Istogut e as në odën në Cerce. Kjo tregon se Saiti e kishte përkrahjen e popullit të Istogut. Dhe, për mungesë të provave, Saiti nuk u dënua por vazhdoi të mbahej në burgun e Tiranës.

Në gusht të vitit 1944, nga burgun e Tiranës e transferojnë në burgun-kampin nazist të Prishtinës. Si i burgosur punoi në hekurudhë në kushte të vështira dhe me rrezik, por së bashku me Enver Dajçin arriti të ikte nga burgu kampi i Prishtinës. Dhe me shumë vështirësi e rreziqe kalojnë nëpër Drenicë dhe arrijnë në bjeshkët e Istogut në Vojdoll mbi Rakosh.

Luftoi në Kosovë

Në Vojdoll së bashku me Ismet Shaqirin e Enver Dajçin marrin pjesë në formimin e Batalionit të Parë dhe të Dytë të Rakoshit. Me Batalionin e Parë Ismet Shaqiri kalon nëpër Drenicë dhe vazhdon rrugën për Ferizaj, ndërsa, Sait Zatriqi me Batalionin e Dytë më 17 nëntor 1944 e çlirojnë Istogun me rrethinë dhe formojnë Komandën e Vendit. Me formimin e pushtetit, Saiti zgjedhet njëherë sekretar e mandej kryetar i Këshillit të Rrethit dhe kryetar i Komisionit për Politikë Agrare të Rrethit të Istogut.

Në vitin 1945 e 1946 janë kthyer kolonistët serbë e malazez duke kërkuar dhe tentuar që të vendosen përsëri në toka të shqiptarëve në bazë të vendimeve të regjimit skllavërues serbo-jugosllav. Atëherë Saiti, si Kryetar i Komisionit për Politikë Agrare Sait është treguar shumë i vendosur dhe guximtar. Të gjithë fshatarëve shqiptarë, të cilëve u ishte marrë toka nga regjimi para 7 prillit 1941 në Rrethin e Istogut iu ka pranuar të drejtën pronësore si pronarëve legjitimë. Për këto vendime e veprime, merita të posaçme ka Saiti si kryetar i Komisionit për Politikë agrare dhe si udhëheqës politik i Rrethit të Istogut.

Mbahen në mend edhe raste të tjera në të cilat Saiti është treguar i vendosur e guximtar, por edhe i drejtë e konsekuent. Në territorin e Rrethit të Istogut në korrik të vitit 1945 është paraqitur një tog partizano-çetnik me uniforma partizane duke kërkuar nëpër fshatra ushqim (mish e pite) dhe duke mbajtur fjalime kinse për të drejtat e popullit serb dhe të drejtat pronësore të kolonistëve serbo-malazez. Sait Zatriqi, me aktivitetin e tij politikë organizon një tubim me fshatarë të fshatit Pogragjë, tani Komuna e Klinës. Gjatë këtij tubimi vjen komandanti i togut në fjalë dhe e ndërpret fjalimin e Saitit duke e pyetur se kush të ka autorizuar për këtë tubim dhe duke iu drejtuar revolen në gjoks. Atëherë, truproja e Saitit, Ajet Selmani, nga Zhakova, komiti i vjetër, ia drejton armën këtij eprori serb dhe e çarmatos. Me këtë rast eprori arrestohet nga njësi për mbrojtjen e popullit me urdhër të Rasim Çerkezit nga Mitrovica, atëherë shef i OZN-es-UDB-ës për Rrethin e Istogut, i cili në atë kohë ka lënë vepra të mira gjatë shërbimit në Rrethin e Istogut.

Në dhjetor 1944, janar, shkurt e mars 1945 ishte gjendje e jashtëzakonshme në Kosovë. Gjendja ishte shumë e acaruar edhe në rrethin e Istogut. Këtë situatë e kanë shfrytëzuar nacionalistët dhe njësit partizano-çetnikë serbo-malazez për të ekzekutuar njerëz të pafajshëm. Në këtë kohë janë bërë shumë krime dhe masakra edhe në Istogut. Është vrarë edhe hoxha i Istogut Haxhi Jahjaja, imam i Istogut, intelektual e përparimtar. Njerëzit nuk e ndienin veten të sigurt



në shtëpinë e vet. Për t'i ikur kësaj pasigurie njerëzit iknin nga shtëpitë e tyre dhe dilnin në mal në bjeshkët e Istogut. Kështu rreth 250 veta u detyruan t'i lënë rob e fëmijë dhe ikën në mal, duke ardhur në familje ndonjëherë vetëm natën për t'u furnizuar me ushqime e veshmbathje.

Kundërshtoi degradimin e autonomisë së Kosovës

Sait Zatriqi si udhëheqës politik i Rrethit të Istogut i propozon sekretarit të Komitetit Krahinor me e marrë një vendim politik për amnistinë e këtyre njerëzve të cilët janë larguar nga shtëpitë e veta për ta shpëtuar kokën gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, të cilët nuk kanë bërë asnjë veprë penale. Propozimi aprovet dhe merret vendimi për amnistimin e tyre. Madje edhe ndaj 45 njerëzve që cilët nuk besuan t'u dorëzohen organeve të Rrethit të Istogut e iu dorëzuan Brigadës së Tretë të Shqipërisë, e cila ishte kthyer nga Sanxhaku e Bosnja në prill 1945, nuk është marrë asnjë masë qoftë penale apo administrative.

Këto veprime të Sait Zatriqit në të mirë të shqiptarëve, hasën në pakënaqësi të disa kadrove serbo-malazeze, sidomos rreth politikës agrare dhe angazhimin për amnistinë. Në bisedë me Mita Milkoviçin, anëtar i Byros së Komitetit Krahinor, i ka thënë Saitit se po qarkullojnë fjalë se po ua mban krahun shqiptarëve. Saiti i përgjigjet se, si udhëheqës politik sillet njëjtë me të gjithë, pa dallim të përkatësisë nacionale.

Gjatë periudhës, dhjetor 1944, janar, shkurt e mars 1945, kurë edhe u kryen masakra në Istog me rrethinë në udhëheqësin kryesore në Rrethin e Istogut kanë qenë: Dushan Popoviç, malazez, shef i OZNËS, Radoje Millosheviç, malazez sekretar i Komitetit të Rrethit, Ruzha Raçeçiq, sekretare organizative e Komitetit të Rrethit. Kjo garniturë e kadrove udhëheqëse janë fajtorë për të gjitha krimet e masakrat që janë kryer në Istog me rrethinë gjatë periudhës, dhjetor 1944, janar, shkurt e mars 1945. Në tetor 1947 Saiti, nga organet e Rrethit të Istogut, transferohet në organet Krahinore në detyrë të anëtarit të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit Krahinor në Prishtinë. Në vitin 1949 ishte edhe udhëheqës i Drejtoratit për punë të brendshme të Krahinës Autonome të Kosovës. Në pranverë të vitit 1949 ndodh një atentat, me ç'rast në zyrën e vet vritet kryetari i Komunitetit të Vrellës Rexhep Kadaj. Gjatë aksionit për zbulimin e këtij krimi keqtrajtohen shumë qytetar të Vrellës. Millan Petrushiqi, sekretar i Komitetit për Istog së bashku me shefin e UDB-së

në Pejë marrin vendim për pushkatimin e 11 banorëve të Vrellës si të dyshimtë për organizimin e vrasjes së kryetarit, përderisa vrasësi ka qenë nga një fshat tjetër. Për këtë vendim informohen Fadil Hoxha, Gjoko Paçkoviç i Sait Zatriqi, të cilët nëpërmjet lidhjes telefonike e ndalojnë ekzekutimin të njerëzve të pafajshëm. Me këtë rast Fadil Hoxha brenda 4 orëve arrin në Vrellë dhe i merr masat e nevojshme për qetësimin e situatës së krijuar në lidhje me vrasjen e kryetarit të Vrellës.

Dhjetë vjet asi ishte vrarë kryetari i komunës së Vrellës, ndodh edhe një vrasje tjetër, me ç'rast vritet në oborrin e vet një qytetarë nga Vrella. Në vend të krimit si prova materiale gjenden gëzhojat e plumbave të revoles. Vrasja e kryetarit të Vrellës nuk ishte zbardhur deri atëherë, gëzhojat e plumbave që ishin gjetur në vendin e ngjarjes ishin ruajtur për 10 vjet. Instituti kriminalistik i Beogradit dhe pasi i krahason gëzhojat vërteton se

ministër i mbrojtjes së Jugosllavisë e organizon një takim me Sait Zatriqin në të cilin diskutohet që shtabi territorial i Kosovës të hyn nën juridiksionin e atij të Serbisë. Këtë propozim Saiti e kundërshton, me arsyetimin se shtabi i Kosovës është direkt i lidhur me organet e Federatës së Jugosllavisë dhe se si komandant është emëruar me dekret të kryetarit të Jugosllavisë. Pas kësaj bisede Lubiçiqi e përgatit për propozim një vendim, me të cilin parashihet se, komandantet e shtabeve territoriale të republikave e krahinave duhet ta kenë gradën gjeneral. Pasi që Saiti nuk e ka pasur atë gradë e dorëzon detyrën e komandantit të Shtabit Territorial.

Saiti pas Plenumit të Brioneve më 1966 emërohet kryetar i Komisionit Shtetëror për Hulmimin e deformimeve të keqpërdorimeve të sigurimit shtetëror gjatë kohës së Rankoviçit. Gjatë kësaj kohe Saiti ka dhënë një kontribut të jashtëzakon-



të dy krimet janë kryer me të njëjtën armë. Dhe i dyshuari arrestohet, e pranon veprën dhe dënohet.

Po përmend me këtë rast edhe një intervenim të Sait Zatriqit. Në vitin 1962 Beogradi e përgatit propozimin për riorganizimin e organeve lokale në Serbi. Në këtë propozim ishte përfshirë edhe Kosova me u nda si rrethet: Nishi, Kragujevci, Uzhica, Klarevë, Negotini etj. Qëllimi i këtij propozimi ishte degradimi i kompetencave të organeve të Kosovës dhe shpartallimi territorial. Këtë propozim e kundërshtojnë Saiti me kuadrot shqiptare të Kosovës. Këtë qëndrim të shqiptarëve i bashkëngjitet edhe Cica Paternogiq, nga Prizreni. Në bazë të kundërshtimit të kuadrove shqiptare, Serbia në atë kohë detyrohet ta ndërprejë këtë aksion, por gjatë gjithë kohës e ruan momentin e volitshëm për ta zbatuar këtë plan, për ta nënshtruar Kosovën nën juridiksionin e vet. Edhe Lubiçiqit i tha: JO!

Në vitin 1967 Saiti zgjedhet kryetar i dhomës Krahinore, deputet federativ. Më 1973 emërohet komandant i Shtabit territorial të Krahinës Autonome të Kosovës. Në bashkëpunim me komuna, me sukses e organizon mbrojtjen territoriale të Kosovës. Njësitë territoriale aftësohen me ushtrim duke u kompletuar edhe me armë të lehta e moderne. Si komandant i Shtabit të Mbrojtjes Territoriale, emërohet me dekret të Komandantit Suprem të Forcave të Armatosura dhe kryetarit të Republikës së Jugosllavisë. Shtabi ka qenë direkt i lidhur me komandën supreme të Jugosllavisë. Nikolla Lubiçiqi,

shëm në demaskimin e keqpërdorimit e krimeve të UDB-së dhe në shkarkimin e dënimit e bartësve të këtyre deformimeve.

Në mbledhjen e Komisionit kompetent të Kuvendit të Jugosllavisë të vitit 1981, Sait Zatriqi i kundërshtoi me vendosmëri tendencat evidente për degradimin e pozitës kushtetuese të Kosovës si element konstituviv i federatës. Dhe, këtë kundërshtim e ka bërë në të gjitha nivelet e organeve të ish-Jugosllavisë.

Në jetën e vet politike si sekretar Komiteti i Rrethit, kryetar i dhomës Krahinore, kryetar i Komisionit për Politikë Agrare, komandant i Shtabit Territorial të Kosovës, kryetar i SHVLANÇK, së bashku me kuadrot tjera shqiptare e ka dhanë kontributin e vet për zhvillimin e cilësinë territoriale dhe autonominë e Kosovës.

Saiti si udhëheqës e punëtor politik, në veprimet e tij ka qenë i vendosur, guximtar, human ndaj nevojave e kërkesave të arsyeshme të qytetarëve e i ashpër kundër burokratizmit, nacionalizmit, papërgjegjësisë dhe të gjitha dukurive negative në shoqëri.

Sadri Kabashi
Anëtar i Kryesisë së SHVLANÇK

(Fjala e mbajtur në tubimin përkujtimor me rastin e 5-vjetorit të ndarjes nga jeta të Sait Zatriqit (1918-2008), pjesëmarrës aktiv i LANÇ të Kosovës dhe bartës i Përkujtimores Partizane. 1941)

KULTURE

Presidenti Federal i Republikës së Austrisë dekoron me Kryqin Austriak të Nderit për Shkencën dhe Artin drejtorin e TKOB

Austria dekoron Zhani Cikon

Ciko është jo vetëm një njohës dhe adhurues i kulturës dhe muzikës austriake, por edhe një drejtues dhe realizues i shumë veprave të kësaj muzike

Presidenti Federal i Republikës së Austrisë dekoron me Kryqin Austriak të Nderit për Shkencën dhe Artin, dirigjentin dhe drejtorin e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit në Tiranë, mjeshtrin Zhani Ciko. Kjo dekoratë e lartë nderimi nga pala austriake, maestro Zhani Ciko iu dorëzua me ceremoni në Tiranë, nga ambasadori austriak Florian Raunig.

Mjeshtri Zhani Ciko, i cili ka lindur në vitin 1945 në Tiranë, është që prej dhjetë vitesh drejtor i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit.

Ciko është jo vetëm një njohës

dhe adhurues i kulturës dhe muzikës austriake, por edhe një drejtues dhe realizues i shumë veprave të kësaj muzike.

Veçanërisht, gjatë viteve të fundit pati një bashkëpunim akoma më intensiv me Ambasadën Austriake në Tiranë, ndër të tjera në realizimin e projekteve të përbashkëta si "Vejusha Gazmore" në vitin 2011, "Flauti Magjik" në vitin 2012 dhe "Don Giovanni" në vitin 2013.

Përveç punës drejtuese dhe artistike, maestro Zhani Ciko komenton rregullisht prej mëse 20 vitesh transmetimin e drejtpërdrejtë të Koncertit të Vjenës, në Radio

Televizionin Publik Shqiptar dhe prej 10 vitesh organizon një event elitari si ballo e fundvitit "From Vienna to Tirana", ku në fokus janë muzika dhe baleti austriak.

Si përmes punës së tij aktive në promovimin e kulturës dhe muzikës austriake, ashtu edhe në zgjerimin e bashkëpunimit dypalësh përmes projekteve kulturore në Shqipëri me mbështetje nga Austria, maestro Zhani Ciko ka meritat të mëdha të cilat vlerësohen lartë nga Presidenti Federal i Austrisë, përmes akordimit të Kryqit Austriak të Nderit për Shkencën dhe Artin.



Rreth librit "Mes shokësh, në shërbim të Atdheut", shkruar nga Koloneli në pension Hysë Xhemali Hasa

Jeta ushtarake e përshkruar me hollësi, vërtetësi e thjeshtësi

Nga RRAHMAN PARLLAKU*

Koloneli në pension Hysë Xhemali Hasa, në librin me titull "Mes shokësh, në shërbim të Atdheut", e shpalos bukur jetëshkrimin e tij. Kështu, shkruan për vitet e adoleshencës dhe rinisë së hershme, kur ëndërronte e meditonte për jetën. Shkruan për vitet e shkollës së mesme, që i hapën rrugën e të ardhmes dhe kur ai mësonte me zell e me këmbëngulje, për të arritur aspiratat e tij.

Libri në fjalë përmban, kryesisht, jetën e veprimtarinë e Hysës në shërbim të Ushtrisë sonë. Kohën e shërbimit ai e përshkruan me hollësi, vërtetësi e thjeshtësi, duke filluar nga jeta ushtar e më pas duke qenë kursant i shkollës ushtarake dhe deri te shërbimi oficer, me karrierë të gjatë në detyrë. Ai flet me respekt për mësuesit e pedagogët. Ndërsa me respekt e nderim të thellë shkruan edhe për eprorët, për kolegët, por edhe për vartësit e tij.

Me thjeshtësi e vërtetësi, Hysa e përshkruan jetën e ushtarakut, oficer aktiv në 35 vite, duke na kujtuar vështirësitë e sakrificat e shumta, që kërkonte detyra e oficerit. Kështu, libri i tij më ka ngjallur emocione të forta jo vetëm mua, që jam sot në moshën 94-vjeçare, por edhe çdo oficeri tjetër, që e ka përjetuar shërbimin ushtarak.

Në këtë libër, ai shkruan hollësisht për sukseset në detyrë, për kënaqësitë e gëzimet, kur puna, munda e djersa e derdhur i janë vlerësuar e shpërblyer. Por dhe është hidhëruar, kur të aftëve në detyrë, padrejtësisht, nuk u është vlerësuar puna; ndërsa servilet e të paaftët kanë përfituar nga "nepotizmi", siç e quan ai. Hysa shkruan me dashamirësi e humanizëm për njerëzit, pa bërë dal-



lime në mendime e vlerësime, si për gjeneralin, për kolonelin, për kapterin ose ushtarin, duke shpalosur njerëzoren e karakterit të tij, jashtë pozitës ose pushtetit.

Si në dy botimet e mëparshme, edhe në këtë libër, në vlerësimet për njerëzit, Hysa shmang çdo dallim politik e shoqëror, nuk pyet për prejardhjen e tyre. Pra, vlerëson qëndrimin në punë dhe ndershmërinë dhe përkushtimin e secilit, në kryerjen e detyrës së caktuar. Meritë e tij është që nuk shkruan "bardh e zi" për njerëzit, siç kanë bërë rëndom autorët, në të kaluarën dhe si, fatkeqësisht, vazhdon të shkruhet, në shumë raste, edhe sot.


Në librin e parë të Hysës, "Vila, krenaria e Lumës", që është vendlindja e tij, Hysa ngre lart burrat e shquar të asaj krahine, që prej thellësisë së shekujve dhe deri në ditët tona. Ata janë vlerësuar, si për ndihmesën e tyre në luftërat për liri e pavarësi të Kombit tonë, por edhe për atë, që kanë dhënë në fushën e dijes e deri në drejtimin e Perandorisë së kohës.

Në librin tjetër të tij, "Midis emigrantëve shqiptarë në Amerikë", ku ka vite që Hysë Hasa jeton familjarisht, në qendër gjejmë edhe figurat e qindra kuksianëve, të cilët me aftësitë e tyre ditën të integrohen mjaft mirë në shoqërinë amerikane.

Ndihesh krenar, kur lexon për mënyrën, se si ata janë përshtatur me punën, si i kanë sistemuar familjet e tyre dhe si po i shkollojnë fëmijët, shumë prej të cilëve e ndjekin Universitetin. Ka ndër ata, që kanë marrë tituj shkencorë, janë bërë pedagogë të njohur, siç ka edhe mjaft të tjerë, që kanë ngritur bizneset e tyre.

Jam i bindur se libri "Mes shokësh, në shërbim të Atdheut", do t'i vlejë historiografisë shqiptare, pasi në të jepen mendime e bëhen analiza për etapat e kaluara nga Forcat tona të Armatosura, në periudha të ndryshme kohore, ku Hysa ndalet veçanërisht në dy nga çastet më të rënda të Ushtrisë sonë. Së pari, në vitet 1965-1966, kur nën diktatin direkt të Enver Hoxhës u ndërmorën, nga Komiteti Qendror i Partisë dhe nga Këshilli i Mbrojtjes, të ashtuquajturat reforma, që goditën rëndë përgatitjen dhe gatishmërinë luftarake të Ushtrisë sonë. Me atë rast, u dënuan me pushkatim, burgim, internim dhe u persekutuan qindra kadro të Ushtrisë, gjeneralë e oficerë nga më të aftët. Ata kishin komanduar Luftën Nacionalçlirimtare dhe kishin përvojë 30-vjeçare në drejtimin e Ushtrisë, kishin mbaruar akademi të larta ushtarake dhe e kishin përgatitur e aftësuar Ushtrinë tonë, për t'u krahasuar me ushtritë më të përparuara europiane. Së dyti, ndalet në vitet 1996-1997, kur Hysa i analizon ngjarjet, duke jetuar brenda tyre, i pranishëm me kulturën, përvojën dhe këndvështrimin e tij profesional, që ia vlen të studiohet dhe vlerësohet, si nga të gjithë historianët ushtarakë e më gjerë.

Së fundmi, i uroj autorit të këtij libri, Hysë Hasës, gazime e lumturi në familje dhe punë të mbarë, që të



na japë edhe shumë libra të tjerë, si këta, për të cilët fola shkurtimisht! *Lexuar në përrurimin e librit,

për të cilin shkruan, më 31 gusht 2013, në sallën kryesore të Muzeut Historik Kombëtar, në kryeqytet)